
Udhëzuesi referencë i instaluesit

Kondicioner me ndarje me qëndrim në dysheme





CVXM20C2V1B
FVXM25C2V1B
FVXM35C2V1B
FVXM50C2V1B

Tabela e përmbajtjes

1 Rreth dokumentacionit 4
1.1 Kodi i produktit 4
1.2 Rreth këtij dokumenti 4

2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme 5
2.1 Rreth dokumentacionit 5
2.1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve 5

3 Udhëzimet e sigurisë për përdoruesin 7
3.1 Të përgjithshme 7
3.2 Udhëzimet për përdorim të sigurt 8

4 Rreth sistemit 11
4.1 Njësia e brendshme 11
4.1.1 Llamba e treguesit të syrit Daikin 12
4.2 Rreth ndërfaqes së përdoruesit 12
4.2.1 Përbërësit: Telekomanda uajrles 13
4.2.2 Statusi: Ekrani LCD i telekomandës uajrles 14
4.2.3 Operimi i telekomandës uajrles 15
4.3 Rreth LAN-it me valë 15
4.3.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë 16
4.3.2 Parametrat bazë 16

5 Para përdorimit 17
5.1 Pamje përgjithshme: Para përdorimit 17
5.2 Ndezja e furnizimit me energji 17
5.3 Vendosja e baterive 17
5.4 Montimi i mbajtëses së telekomandës uajrles 18
5.5 Caktimi i dorës 18
5.5.1 Caktimi i orës 18
5.6 Ndriçimi i ekranit të njësisë së brendshme 19
5.6.1 Caktimi i ndriçimit të ekranit të njësisë së brendshme 19

6 Përdorimi 20
6.1 Gama e operimit 20
6.2 Kur përdoren funksionet 20
6.3 Gjendja e operimit dhe vlera e dëshiruar e temperaturës 22
6.3.1 Fillimi/ndalja e modalitetit të operimit dhe caktimi i temperaturës 22
6.4 Shkalla e qarkullimit të ajrit 23
6.4.1 Rregullimi i shkallës së qarkullimit të ajrit 23
6.5 Drejtimi i qarkullimit të ajrit 23
6.5.1 Rregullimi i drejtimit të qarkullimit vertikal të ajrit 24
6.5.2 Rregullimi i frëngjive të ajrimit (tehet vertikale) 24
6.6 Kontrolli i Kompensimit të Klimës (CCC) 25
6.6.1 Fillimi/ndalimi i kontrollit të kompensimit të Klimës (CCC) 26
6.7 Kontakti i NDEZJES/FIKJES 26
6.8 Preferenca për ajër të nxehtë 27
6.8.1 Nisja/ndalimi i preferencës për ajër të nxehtë 28
6.9 Kufiri i temperaturës 28
6.9.1 Caktimi i kufirit të temperaturës 29
6.10 Zgjedhja e daljes së ajrit 30
6.10.1 Vendosja e zgjedhjes automatike të daljes së ajrit ose vetëm dalja e sipërme e ajrit 31
6.11 Cilësimi i ventilatorit të njësisë së brendshme kur termostati është i fikur në ftohje 31
6.11.1 Kontrollimi i ventilatorit të njësisë së brendshme kur termostati është i fikur në ftohje 31
6.12 Operimi i ngrohjes së dyshemesë 32
6.12.1 Fillimi/ndalimi i operimit të ngrohjes së dyshemesë 32
6.13 Operimi i fuqishëm dhe ngrohje plus 32
6.13.1 Operimi i fuqishëm 32
6.13.2 Operimi ngrohje plus 33
6.13.3 Fillimi/ndalimi i operimit të fuqishëm dhe ngrohje plus 33
6.14 Butoni i përdorimit të qetë dhe ekonomik të njësisë së jashtme 34
6.14.1 Operimi ekono 34
6.14.2 Operimi në qetësi i njësisë së jashtme 34
6.14.3 Fillimi/ndalimi i përdorimit të qetë dhe ekonomik të njësisë së jashtme 35
6.15 Operimi i Flash Streamer (pastrimi i ajrit) 35
6.15.1 Nisja/ndalimi i operimit të Flash Streamer (pastrimi i ajrit) 35

6.16 Operimi i kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES ... 36
6.16.1 Cilësimi i kohëmatësit të FIKJES/NDEZJES 24 orësh ... 36
6.16.2 Cilësimi i kohëmatësit të FIKJES/NDEZJES me numërim mbrapsht 12 orësh ... 37
6.17 Operimi i kohëmatësit javor ... 38
6.17.1 Caktimi i operimit të kohëmatësit javor ... 39
6.17.2 Kopjimi i rezervimeve ... 40
6.17.3 Konfirmimi i rezervimeve ... 41
6.17.4 Për të çaktivizuar dhe riaktivizuar operimin e kohëmatësit javor ... 41
6.17.5 Fshirja e rezervimeve ... 42
6.18 Lidhje uajrles LAN ... 42
6.18.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë ... 43
6.18.2 Instalimi i aplikacionit ONECTA ... 43
6.18.3 Caktimi i lidhjes uajrles ... 43
6.19 Rreth Multi-sistemit ... 45
6.19.1 Cilësimi i dhomës me përparësi ... 46
6.19.2 Modaliteti i heshtjes natën ... 47
6.19.3 Kyçi i modalitetit të ftohjes/ngrohjes në Multi-sistem ... 47

7 Kursimi i energjisë dhe operimi optimal 48

8 Mirëmbajtja dhe shërbimi 50
8.1 Pamje përgjithshme: Mirëmbajtja dhe shërbimi ... 50
8.2 Pastrimi i njësisë së brendshme dhe telekomandës uajrles ... 51
8.3 Pastrimi i panelit të përparmë ... 52
8.4 Rreth filtrave të ajrit ... 52
8.5 Heqja e filtrave ... 53
8.6 Pastrimi i filtrit të ajrit ... 53
8.7 Pastrimi i filtrit aromatizues prej apatiti titani ... 54
8.8 Ndërrimi i filtrit aromatizues prej apatiti titani ... 54
8.9 Rivendosja e filtrave ... 55
8.10 Ri-instalimi i panelit të përparmë ... 55
8.11 Marrja parasysh e pikave të mëposhtme para një periudhe të gjatë ... 56

9 Zgjidhja 57
9.1 Zgjidhja e problemeve për lidhjen e LAN-it me valë ... 60
9.2 Simptomat që NUK janë keqfunksionime të sistemit ... 61
9.2.1 Shenja: Temperatura e qarkullimit të ajrit NUK është aq e lartë gjatë operimit të Nxehjes Plus ... 61
9.2.2 Simptoma: Dëgjohet një zë sikur rrjedh ujë ... 61
9.2.3 Simptoma: Dëgjohet një zë fryrës ... 61
9.2.4 Simptoma: Dëgjohet një zë tik-tak ... 61
9.2.5 Simptoma: Dëgjohet një zë fishkëllues ... 61
9.2.6 Simptoma: Dëgjohet një zë gjatë operimit ose kohës jo produktive ... 61
9.2.7 Simptoma: Dëgjohet një zë gjëmues ... 61
9.2.8 Shenja: Nga njësia (njësia e brendshme) dalin pikla të bardha ... 61
9.2.9 Shenja: Njësitë mund të lëshojnë aroma ... 62
9.2.10 Simptoma: Ventilatori i jashtëm rrotullohet kur kondicioneri nuk është në përdorim ... 62
9.2.11 Shenja: Shpejtësia ventilatorit NUK përkon me vlerën e dëshiruar ... 62
9.2.12 Shenja: Disa ikona operimi nuk janë të dukshme në telekomandën uajrles ose disa funksione nuk mund të aktivizohen në aplikacionin ONECTA ... 62
9.2.13 Shenja: Në aplikacionin ONECTA, operimi i fuqishëm NUK tregohet si aktiv ... 62
9.2.14 Shenja: Modaliteti automatik NUK është i çaktivizuar në aplikacionin ONECTA me cilësimin e kufirit të Temperaturës ... 62
9.2.15 Shenja: Kohëmatësi javor NUK çaktivizohet kur kufiri i temperaturës ndryshon në aplikacionin ONECTA 62
9.2.16 Shenja: Aplikacioni ONECTA reagon me vonesë ... 63
9.3 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit ... 63

10 Hedhja 65

11 Fjalor 66

1 Rreth dokumentacionit

1.1 Kodi i produktit

CVXM20C, FVXM25C, FVXM35C, FVXM50C

1.2 Rreth këtij dokumenti

Faleminderit që bletë produktin. Ju lutemi:

- Ruajeni dokumentacionin për referencë në të ardhmen.

Audienca e synuar

Përdoruesit fundorë

INFORMACION

Qëllimi i kësaj pajisjeje është përdorimi nga përdoruesit ekspertë ose të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar ose shtëpiak nga jo profesionistë.

Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:**
  - Udhëzimet e sigurisë që duhet të lexoni para përdorimit të sistemit
  - Formati: Letër (te kutia e njësisë së brendshme)
- **Manuali i përdorimit:**
  - Udhëzues i shpejt për përdorimin bazë
  - Formati: Letër (te kutia e njësisë së brendshme)
- **Udhëzuesi referencë i instaluesit:**
  - Udhëzime të detajuara hap pas hapi dhe informacion për përdorimin bazë dhe atë të përparuar
  - Formati: Skedarët digjitalë në https://www.daikin.eu. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimet më të fundit të dokumentacionit të siguruar mund të disponohen në faqen rajonale Daikin ose përmes instaluesit tuaj.

Skanoni kodin QR më poshtë për të gjetur setin e dokumentacionit të plotë dhe më shumë informacion rreth produktit tuaj në uebfaqen e Daikin.

FVXM-C

CVXM-C

Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme

2.1 Rreth dokumentacionit

- Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të origjinalit.
- Masat paraprake të përshkruara në këtë dokument mbulojnë tema shumë të rëndësishme, ndiqi ato me kujdes.
- Instalimi i sistemit, dhe të gjitha aktivitetet e përshkruara te manuali i përdorimit dhe udhëzuesi referencë i instaluesit DUHET të kryhen nga një instalues i autorizuar.

2.1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve



RREZIK

Tregon një situatë që rezulton në vdekje ose dëmtim të rëndë.



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Tregon një situatë që mund të rezultojë në goditje elektrike.



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

Tregon një situatë që mund të rezultojë në djegie/përvëlim për shkak të temperaturave ekstreme të ngrohta ose të ftohta.



RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Tregon një situatë, që mund të rezultojë në shpërthim.



PARALAJMËRIM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në vdekje ose dëmtim të rëndë.



ALARM: MATERIAL I NDEZSHËM



ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.



KUJDES

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtim të lehtë ose të mesëm.



NJOFTIM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtimin e pajisjeve ose të pronës.



INFORMACION

Tregon këshilla të dobishme ose informacion shtesë.

Simbolet e përdorura në njësi:

Simboli	Shpjegimi
	Para instalimit, lexoni manuali i instalimit dhe përdorimit dhe fletën e udhëzimit për lidhjet elektrike.
	Para kryerjes së detyrave të mirëmbajtjes dhe shërbimit, lexoni manualin e shërbimit.
	Për më shumë informacion, shikoni instaluesin dhe udhëzuesin referencë të përdoruesit.
	Njësia përmban pjesë rrotulluese. Bëni kujdes kur i bëni njësisë servis ose inspektim.

Simbolet e përdorura në dokumentacion:

Simboli	Shpjegimi
	Tregon një titull figure ose një referencë për të. **Shembull:** "1–3 Titulli i figurës" do të thotë "Figura 3 në kapitullin 1".
	Tregon një titull tabele ose një referencë për të. **Shembull:** "1–3 Titulli i tabelës" do të thotë "Tabela 3 në kapitullin 1".

3 Udhëzimet e sigurisë për përdoruesin

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

3.1 Të përgjithshme

PARALAJMËRIM

Nëse NUK jeni të sigurt sesi ta përdorni njësinë, kontaktoni me instaluesin.

PARALAJMËRIM

Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe personat me aftësi të reduktuara fizike, ndijore ose mendore ose me mungesë përvoje dhe njohurie, nëse u janë dhënë mbikëqyrje ose udhëzime lidhur me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt dhe për të kuptuar përfshirjen e rreziqeve.

Fëmijët NUK do të luajnë me pajisjen.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit NUK do të kryhet nga fëmijë pa mbikëqyrje.

PARALAJMËRIM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësinë.
- MOS e përdor njësinë me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.

KUJDES

- MOS vendosni sende ose pajisje mbi njësinë.
- MOS u ulni, mos hipni ose mos qëndroni mbi njësinë.

- Njësitë janë të shënuara me këtë simbol:



Kjo do të thotë se produktet elektrike dhe elektronike NUK mund të përzihen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake. MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET bërë nga një instalues i autorizuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim. Duke garantuar që ky produkt do të hidhet si duhet, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Për më shumë informacion, kontaktoni instaluesin tuaj ose autoritetin lokal.

- Bateritë janë të shënuara me këtë simbol:



Kjo do të thotë se bateritë NUK mund të përzihen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake. Nëse një simbol kimik është i shtypur poshtë simbolit, ky simbol kimik do të thotë se bateria mban një metal të rëndë mbi një koncentrim të caktuar.

Simbolet e mundshme kimike janë: Pb: plumb (>0,004%).

Bateritë për hedhje DUHEN trajtuar në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim. Duke garantuar që bateritë për hedhje do të hidhen si duhet, ju do të

ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor.

3.2 Udhëzimet për përdorim të sigurt



PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.



ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.



KUJDES

Njësia e brendshme përmban pajisje radioje; distanca minimale e ndarjes mes pjesës së rrezatimit të pajisjes dhe përdoruesit është 30 cm.



KUJDES

Kjo njësi është e pajisur me një sistem zbulimi kundër rrjedhjes për siguri. Për të qenë efektiv, njësia duhet të furnizohet me energji elektrike gjatë gjithë kohës pas instalimit, përveç kur i kryhet shërbim.



KUJDES

MOS vini gishtat, shufra apo sende të tjera te pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit. Kur ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë, shkaktohet lëndim fizik.



PARALAJMËRIM

- MOS modifikoni, çmontoni, hiqni, riinstaloni apo riparoni njësinë vetë, sepse çmontimi ose instalimi i pasaktë mund të shkaktojë tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.
- Në rast rrjedhjeje të rastësishme të ftohësit, sigurohuni që nuk ka flakë të hapura. Vetë ftohësi është krejtësisht i sigurt, jo toksik dhe lehtësisht i ndezshëm, por do të gjenerojë gaz toksik kur rrjedh aksidentalisht në një dhomë ku ka prani të ajrit për djegie nga ngrohës ventilatorësh, furnela gazi, etj. GJITHMONË kontaktoni personelin e kualifikuar të shërbimit të konfirmojë që pika e rrjedhjes është riparuar ose ndrequr para rifillimit të operimit.



KUJDES

- GJITHMONË përdorni një ndërfaqe përdoruesi (p.sh. telekomandë uajrles) për të rregulluar këndin e kapakut të xhepit. Kur kapaku i xhepit lëkundet dhe ju e lëvizni me dorë me forcë, mekanizmi prishet.
- Bëni kujdes kur rregulloni frëngjitë e ajrimit. Brenda pjesës së daljes së ajrit, ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë.



KUJDES

KURRË mos ekspozoni fëmijë të vegjël, bimë apo kafshë direkt me qarkullimin e ajrit.



PARALAJMËRIM

MOS vendosni sende poshtë njësisë së brendshme dhe/ose të jashtme që mund të njomet. Përndryshe kondensimi te njësia kryesore ose tubat e ftohësit, pisllëku i ajrit të filtrit ose bllokimi i drenazhit mund të shkaktojë pikim dhe sendet poshtë njësisë mund të bëhen pis ose dëmtohen.

PARALAJMËRIM

MOS vendosni shishe me spërkatës të djegshëm afër kondicionerit dhe MOS përdorni spërkatës afër njësisë. Kjo gjë mund të shkaktojë zjarr.

KUJDES

MOS e përdorni sistemin kur përdorni një insekticid të llojit të tymosjes së dhomës. Lëndët kimike mund të mblidhen te njësia dhe të rrezikojnë shëndetin e atyre që janë hiper të ndjeshëm ndaj lëndëve kimike.

PARALAJMËRIM

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.

PARALAJMËRIM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).

PARALAJMËRIM

Sensori i rrjedhjes së ftohësit R32 duhet ndërruar pas çdo zbulimi ose në fund të jetëgjatësisë. VETËM personat e autorizuar mund të ndërrojnë sensorin.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Për të pastruar kondicionerin ose filtrin e ajrit, sigurohuni të ndalni operacionin dhe t'i fikni të gjitha furnizimet me energji. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik. Në rast se njësia është e pajisur me sensor për rrjedhjen e ftohësit, ndizni menjëherë sërish çelësin e furnizimit me energji pas pastrimit për të ruajtur funksionalitetin e zbulimit.

KUJDES

Kur ndërroni sensorin e rrjedhjes së ftohësit R32, ndërrojeni me sensorin e specifikuar nga prodhuesi (referojuni listës së pjesëve rezervë).

PARALAJMËRIM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësinë.
- MOS e përdor njësinë me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.

KUJDES

Pas një përdorimi të gjatë, kontrollo mbështetësen e njësisë dhe montimin për dëmtime. Nëse dëmtohet, njësia mund të rrëzohet dhe çojë në dëmtim.

PARALAJMËRIM

Detergjentët e papërshtatshëm ose procedura e pastrimit mund të shkaktojë dëmtim të përbërësve plastikë ose rrjedhje të ujit. Detergjenti i spërkatur në përbërësit elektrikë, si motorë, mund të shkaktojë avari, tym ose ndezje.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Para pastrimit, sigurohuni të ndërpritni operimin, të fikni çelësin ose të tërhiqni kordonin e korrentit. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik. Në rast se njësia është e pajisur me sensor për rrjedhjen e ftohësit, ndizni menjëherë sërish çelësin e furnizimit me energji pas pastrimit për të ruajtur funksionalitetin e zbulimit.

PARALAJMËRIM

MOS e lini njësinë e brendshme të laget. **Pasoja e mundshme:** Shok elektrik ose zjarr.

KUJDES

Bëni kujdes kur hapni dhe përdorni panelin para; skaji i mprehtë i panelit para mund të shkaktojë lëndim.

PARALAJMËRIM

Ndalo operimin dhe fik energjinë, nëse ndodh diçka e pazakontë (erë djegieje, etj.).

Lënia e njësisë në punë në këto rrethana mund të shkaktojë prishje, tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.

PARALAJMËRIM

Në rast se njësia është e pajisur me sensor për rrjedhjen e ftohësit, fikni njësinë duke përdorur butonin ON/OFF për fikje/ndezje vetëm te ndërfaqja e përdoruesit.

4 Rreth sistemit

A2L

ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

KUJDES

Njësia e brendshme përmban pajisje radioje; distanca minimale e ndarjes mes pjesës së rrezatimit të pajisjes dhe përdoruesit është 30 cm.

KUJDES

Kjo njësi është e pajisur me një sistem zbulimi kundër rrjedhjes për siguri. Për të qenë efektiv, njësia duhet të furnizohet me energji elektrike gjatë gjithë kohës pas instalimit, përveç kur i kryhet shërbim.

NJOFTIM

MOS e përdorni sistemin për qëllime të tjera. Për të shmangur çdo përkeqësim të cilësisë, MOS e përdorni njësinë për mjetet e precizonit të ftohjes, ushqimin, bimët, kafshët ose veprat e artit.

4.1 Njësia e brendshme

KUJDES


MOS vini gishtat, shufra apo sende të tjera te pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit. Kur ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë, shkaktohet lëndim fizik.

INFORMACION

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

PARALAJMËRIM

- MOS modifikoni, çmontoni, hiqni, riinstaloni apo riparoni njësinë vetë, sepse çmontimi ose instalimi i pasaktë mund të shkaktojë tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.
- Në rast rrjedhjeje të rastësishme të ftohësit, sigurohuni që nuk ka flakë të hapura. Vetë ftohësi është krejtësisht i sigurt, jo toksik dhe lehtësisht i ndezshëm, por do të gjenerojë gaz toksik kur rrjedh aksidentalisht në një dhomë ku ka prani të ajrit të djegshëm nga ngrohës ventilatorësh, furnela gazi, etj. GJITHMONË kontaktoni personelin e kualifikuar të shërbimit të konfirmojë që pika e rrjedhjes është riparuar ose ndrequr para rifillimit të operimit.



a Paneli i përparmë

b Filtri i ajrit
c 2× filtra aromatizues prej apatiti titani
d Dalja e ajrit
e Kapaku i xhepit (tehu horizontal)
f Marrësi i sinjalit infrakuq për telekomandën uajrles
g Butoni ON/OFF, syri Daikin dhe llamba e kohëmatësit
h Hyrja e ajrit
i Frëngji ajrimi (tehet vertikale)
j Sensori i temperaturës së dhomës


Butoni ON/OFF

Nëse ndërfaqja e përdoruesit (p.sh. telekomanda uajrles) mungon, mund të përdorni butonin e NDEZJES/FIKJES te njësia e brendshme për të filluar/ndalur përdorimin. Kur përdormi fillon duke përdorur këtë buton, përdoren këto cilësime:

- Gjendja e operimit = Automatik
- Cilësimi i temperaturës = 25°C
- Shkalla e qarkullimit të ajrit = Automatik

4.1.1 Llamba e treguesit të syrit Daikin

Ngjyra e syrit Daikin do të ndryshojë sipas operimit.



a Butoni i ON/OFF
b Syri Daikin

Operimi	Ngjyra e syrit Daikin
Automatik	E kuqe/blu
Tharja	Jeshil
Ftohja	Blu
Ngrohja	E kuqe
Vetëm me ventilator	E bardhë
Operimi i kohëmatësit	Portokalli[(a)]

[(a)] Kur është vendosur kohëmatësi i NDEZJES/FIKJES ose kohëmatësi Javor, syri Daikin ndryshon herë pas here në portokalli. Pas ndriçimit me portokalli për rreth 10 sekonda, kthehet në ngjyrën e modalitetit të operimit për 3 minuta. **Shembull:** Kur kohëmatësi është i vendosur gjatë operimit të ftohjes, syri Daikin do të ndriçojë herë pas here ngjyrën portokalli për 10 sekonda, dhe pastaj kalon në ngjyrën blu për 3 minuta.

4.2 Rreth ndërfaqes së përdoruesit

Telekomanda uajrles

INFORMACION


Njësia e brendshme dorëzohet me telekomandën uajrles si ndërfaqja e përdoruesit. Ky manual përshkruan vetëm operimin me këtë ndërfaqe përdoruesi. Nëse lidhet një ndërfaqe tjetër përdoruesi, referojuni manualit të operimit të ndërfaqes së lidhur të përdoruesit.

- **Drita e drejtpërdrejtë e diellit.** MOS e ekspozoni telekomandën uajrles ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit.
- **Pluhuri.** Pluhuri në transmetuesin ose marrësin e sinjalit do të reduktojë ndjeshmërinë. Pastroni pluhurin me një leckë të butë.
- **Dritat fluoreshente.** Komunikimi i sinjalit mund të çaktivizohet nëse në dhomë ka llamba fluoreshente. Nëse është kështu, kontaktoni me instaluesin tuaj.
- **Pajisjet e tjera.** Nëse sinjalet e telekomandës operojnë pajisjet e tjera, lëvizni pajisjet e tjera ose kontaktoni me instaluesin tuaj.
- **Perdet.** Sigurohuni që perdet ose sendet e tjera NUK e bllokojnë sinjalin mes njësisë dhe telekomandës uajrles.

NJOFTIM


- MOS e rrëzoni telekomandën uajrles.
- MOS e lini telekomandën uajrles të laget.

4.2.1 Përbërësit: Telekomanda uajrles



a Transmetuesi i sinjalit
b Monitori LCD
c Butoni i rregullimit të temperaturës
d Butoni i NDEZJES/FIKJES
e Butoni i lëkundjes vertikale
f Butoni i ngrohjes së dyshemesë
g Butoni i menysë
h Zgjidhni butonin
i Butoni i cilësimit të orës
j Butoni i anulimit
k Butonat e operimit të kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES
l Butonat e operimit të kohëmatësit javor
m Butoni i operimit të Flash Streamer (pastrimi i ajrit)
n Butoni i përdorimit të qetë dhe ekonomik të njësisë së jashtme
o Butoni i gjendjes
p Butoni i ventilatorit
q Butoni i fuqishëm dhe butoni i ngrohjes plus


4.2.2 Statusi: Ekrani LCD i telekomandës uajrles



Ikona	Përshkrimi
	Gjendja e operimit = Automatik
	Gjendja e operimit = Tharje
	Gjendja e operimit = Ftohje
	Gjendja e operimit = Ngrohje
	Gjendja e operimit = Vetëm ventilator
▲	Njësia e brendshme merr sinjal nga telekomanda uajrles
ON	Operimi është aktiv
88.8°C	Cilësimi i temperaturës aktuale
	Simboli i njoftimit të ndërrimit të baterisë (bateri e rënë)
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = Automatik
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = Njësia e brendshme në qetësi
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = E lartë
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = E lartë mesatare
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = Mesatare
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = E ulët mesatare
	Shkalla e qarkullimit të ajrit = E ulët
	Operimi i fuqishëm është aktiv
	Operimi ekonomik është aktiv
	Flash Streamer (pastrimi i ajrit) është aktiv
	Nxehja plus është aktive

Ikona	Përshkrimi
	Ngrohja e dyshemesë është aktive
	Operimi në qetësi i njësisë së jashtme është aktiv
	Lëkundja automatike vertikale është aktive
	Dalja automatike e ajrit ose vetëm dalja e ajrit lart është aktive
ON 20:00	NDEZJA e kohëmatësit është aktive
OFF 20:00	FIKJA e kohëmatësit është aktive
WEEKLY	Kohëmatësi javor është aktiv
MONTUEWED THUFRI SATSUN	Dita e javës
20:28	Ora aktuale

4.2.3 Operimi i telekomandës uajrles



a Marrësi i sinjalit infrakuq

Shënim: Sigurohuni që të mos ketë pengesa brenda 500 mm poshtë marrësit të sinjalit infrakuq. Ato mund të ndikojnë në performancën e marrjes të telekomandës.

1 Drejtoni transmetuesin e sinjalit nga marrësi i sinjalit infrakuq te njësia e brendshme (distanca maksimale për komunikim është 7 m).

Rezultati: Kur njësia e brendshme merr një sinjal nga telekomanda uajrles, do të dëgjoni një tingull:

Tingulli	Përshkrimi
Bip-bip	Fillon operimi.
Bip	Cilësimi ndryshon.
Bip i gjatë	Ndalon operimi.
Bip i trefishtë	Sinjali i refuzimit (p.sh. operimi është bllokuar nga kontakti i NDEZJES/FIKJES)

4.3 Rreth LAN-it me valë

Për specifikimet e detajuara, udhëzimet e instalimit, metodat e cilësimit, pyetjet e shpeshta FAQ, deklaratën e pajtueshmërisë dhe versionin e fundit të këtij manuali, vizitoni app.daikineurope.com.

INFORMACION: Deklarata e pajtueshmërisë

Daikin Industries Czech Republic s.r.o. deklaron se lloji i pajisjes së radios brenda kësaj njësie është në pajtim me Direktivën 2014/53/EU.

4.3.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë

MOS e përdorni afër:

- **Pajisjeve mjekësore.** P.sh. personave që përdorin stimulues kardiakë ose defibrilatorë. Ky produkt mund të shkaktojë interferencë elektromagnetike.
- **Pajisjeve me kontroll automatik.** P.sh. dyerve automatike ose pajisjeve të alarmit të zjarrit. Ky produkt mund të shkaktojë defekte të pajisjes.
- **Mikrovalës.** Mund të ndikojë te komunikimet uajrles LAN.

4.3.2 Parametrat bazë

Çfarë	Vlera
Fusha e frekuencës	2400 MHz~2483.5 MHz
Protokolli i radios	IEEE 802.11b/g/n
Kanali i frekuencës së radios	13ch
Energjia output	13 dBm
Energjia efektive e rrezatuar	15 dBm (11b) / 14 dBm (11g) / 14 dBm (11n)
Furnizimi me energji	DC 14 V / 100 mA

5 Para përdorimit

5.1 Pamje përgjithshme: Para përdorimit

Ky kapitull përshkruan çfarë duhet të bëni para se të operoni njësinë.

Ngarkesa tipike e punës

Zakonisht para operimit janë këto faza:

- Ndezja e furnizim me energji.
- Vendosja e baterive në telekomandën uajrles.
- Caktimi i orës.
- Caktimi i ndriçimit të llambës së syrit Daikin.
- Montimi i mbajtëses së telekomandës uajrles në mur ose sipërfaqe tjetër.

5.2 Ndezja e furnizimit me energji

1 Ndizni çelësin e dritës.


5.3 Vendosja e baterive

Bateritë do të zgjasin rreth 1 vit.

1 Hiqni kapakun e përparmë.

2 Vërini bateritë njëkohësisht.


3 Vendosni sërish kapakun e përparmë.



INFORMACION

- Energjia e ulët e baterisë tregohet nga ikona në ekranin LCD.
- GJITHMONË ndërroni të dy bateritë njëkohësisht.

5.4 Montimi i mbajtëses së telekomandës uajrles



a Telekomanda uajrles
b Vidhat (siguruar nga klienti)
c Mbajtësja e telekomandës uajrles

1. Zgjidhni një vend ku sinjali të mund të arrijë njësinë.
2. Fiksoni mbajtësen (aksesorin) në mur ose një vend të ngjashëm duke përdorur 2 vida M3×20L (furnizuar nga klienti).
3. Vendosni telekomandën uajrles në mbajtëse.

5.5 Caktimi i dorës

Nëse ora e njësisë së brendshme NUK është rregulluar si duhet, matësi i NDEZJES, FIKJES dhe matësi javor NUK do të operojnë me përpikëri. Ora duhet të caktohet sërish:


- Pasi një çelës ka FIKUR njësinë.
- Pas një avarie të energjisë.
- Pas ndërrimit të baterive te telekomanda uajrles.

5.5.1 Caktimi i orës

Shënim: Nëse ora NUK është e caktuar në MON, ⏲ dhe 0:00 vezullon.

1. Shtypni ⏲.

   Rezultati: MON dhe ⏲ vezullon.




2. Shtypni Select ose Select për të caktuar ditën aktuale të javës.

Ekrani	Dita e javës
MON	E hënë
TUE	E martë
WED	E mërkurë
THU	E enjte
FRI	E premte
SAT	E shtunë
SUN	E diel

3 Shtypni ⏲.

Rezultati: ⏲ vezullon.




4 Shtypni Select ose Select për të caktuar orën e duhur.

Shënim: Mbajtja poshtë e Select ose Select rrit ose ul cilësimin e orës në mënyrë të shpejtë.

5 Shtypni ⏲.

Rezultati: Cilësimi ka mbaruar. : vezullon.



5.6 Ndriçimi i ekranit të njësisë së brendshme


Përshtatni ndriçimin e ekranit të njësisë së brendshme sipas dëshirës, ose FIKNI ekranin.

5.6.1 Caktimi i ndriçimit të ekranit të njësisë së brendshme

1 Në ekranin e shtëpisë, shtypni Menu për të paktën 2 sekonda.

Rezultati: Numri i zgjedhjes së menysë 1 shfaqet në ekran. 1 po vezullon.

2 Shtypni Menu për të hyrë në cilësim.



3 Shtypni Select ose Select për të ndryshuar cilësimin sipas këtij rendi:



Vezullon	Ndriçimi
H	I lartë
L	I ulët
oF	Fikur

4 Shtypni Menu për të konfirmuar cilësimin e zgjedhur.

Rezultati: Cilësimi i ndriçimit ka ndryshuar.

Shënim: Ekrani do të kthehet automatikisht te monitori i parazgjedhur pas 60 sekondave. Për tu kthyer tek monitori i parazgjedhur shtypni dy herë Cancel.

6 Përdorimi

INFORMACION

Njësia e brendshme dorëzohet me telekomandën uajrles si ndërfaqja e përdoruesit. Ky manual përshkruan vetëm operimin me këtë ndërfaqe përdoruesi. Nëse lidhet një ndërfaqe tjetër përdoruesi, referojuni manualit të operimit të ndërfaqes së lidhur të përdoruesit.

6.1 Gama e operimit

Përdore sistemin në kufijtë vijues të temperaturës dhe lagështisë për përdorim të sigurt dhe të efektshëm.

CVXM		
	Ftohje dhe tharje[a][b]	**Ngrohja[a]**
Temperatura jashtë	-10~46°C DB	-15~24°C DB
Temperatura brenda	18~32°C DB 14~23°C WB	10~30°C DB
Lagështia e brendshme	≤80%[b]	—

[a] Një pajisje sigurie mund ta ndalojë operimin e sistemit nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

[b] Kondensimi dhe pikimi i ujit mund të ndodhë nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

FVXM		
	Ftohje dhe tharje[a][b]	**Ngrohja[a]**
Temperatura jashtë	-10~50°C DB	-20~24°C DB
Temperatura brenda	18~32°C DB 14~23°C WB	10~30°C DB
Lagështia e brendshme	≤80%[b]	—

[a] Një pajisje sigurie mund ta ndalojë operimin e sistemit nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

[b] Kondensimi dhe pikimi i ujit mund të ndodhë nëse njësia punon jashtë gamës së operimit.

6.2 Kur përdoren funksionet

Mund të përdorni tabelën e mëposhtme për të përcaktuar se cilat funksione duhet përdorur:

Funksioni	Detyrat
Funksionet bazë	

Funksioni	Detyrat
Gjendjet e operimit dhe temperatura	Për të filluar/ndalur sistemin dhe për të caktuar temperaturën: ▪ Te gjendja e Ngrohjes dhe Ftohjes, ngrohni ose ftohni dhomën. ▪ Në gjendjen vetëm me Ventilator, lëshoni ajër në dhomë pa ngrohje ose ftohje. ▪ Në gjendjen e Tharjes, ulni lagështinë në dhomë. ▪ Në modalitetin automatik, zgjidhet automatikisht një modalitet i duhur operimi në temperaturën e vendosur.
Drejtimi i qarkullimit të ajrit	Për të rregulluar drejtimin e qarkullimit të ajrit (pozicioni i lëkundjes ose i fiksuar).
Shkalla e qarkullimit të ajrit	Rregulloni sasinë e ajrit që lëshohet në dhomë.
Funksionet bazë	
Streamer	Për të hequr alergjenët e transportuar nga ajri si poleni, substancat ndihmëse dhe për të pastruar ajrin në dhomë.
Ekonomik	Për të përdorur sistemin kur përdorni edhe aparaturat e konsumit të energjisë. Kursimi i energjisë.
Njësia e jashtme është në heshtje	Për të ulur nivelin e zhurmës së njësisë së jashtme. Shembull: Natën.
Zgjedhja automatike e daljes së ajrit	Për ta lënë njësinë të vendosë automatikisht modelin e fryrjes, në varësi të modalitetit të operimit dhe kushteve të dhomës. Ky funksion është i vendosur nga fabrika si cilësim i paracaktuar dhe i rekomanduar.
Vetëm dalja e sipërme	Për ta vendosur qarkullimin e ajrit nga dalja e ajrit vetëm nga sipër, pavarësisht modalitetit të operimit ose kushteve të dhomës.
Ngrohja e dyshemesë	Për të ngrohur daljen e ajrit vetëm nga dalja në fund. Përdorni këtë funksion kur nuk doni të ndjeni qarkullimin e nxehtë të ajrit ballë për ballë.
Ngrohje plus	Për të rritur temperaturën e qarkullimit të ajrit që vjen nga njësia. Temperatura e ajrit do të jetë më e lartë se gjatë operimit normal të ngrohjes. Ky funksion rekomandohet kur doni të ndjeni më shumë ngrohje.
I fuqishëm	Për ta ftohur ose ngrohur dhomën shpejt.
NDEZJA e kohëmatësit + FIKJA e kohëmatësit	NDEZJA ose FIKJA automatike e sistemit.
Matësi javor	Për të NDEZUR ose FIKUR sistemin automatikisht në javë.

Funksioni	Detyrat
Funksione shtesë	
Lidhje uajrles LAN	Përdorimi i njësisë duke përdorur pajisjet inteligjente.

6.3 Gjendja e operimit dhe vlera e dëshiruar e temperaturës

Kur. Rregulloni gjendjen e operimit të sistemit dhe caktoni temperaturën kur doni të:

- Ngrohni ose ftohni dhomën
- Lëshoni ajër në dhomë pa ngrohje ose ftohje
- Ulni lagështinë në dhomë

Çfarë. Sistemi operon ndryshe në varësi të zgjedhjes së përdoruesit.

Cilësimi	Përshkrimi
Automatik	Sistemi ftoh ose ngroh dhomën në vlerën e dëshiruar të temperaturës. Kalon automatikisht nga ftohja në ngrohje nëse është e nevojshme.
Tharja	Sistemi ul lagështinë në dhomë.
Ngrohja	Sistemi ngroh dhomën në vlerën e dëshiruar të temperaturës.
Ftohja	Sistemi ftoh dhomën në vlerën e dëshiruar të temperaturës.
Ventilatori	Sistemi kontrollon vetëm qarkullimin e ajrit (shkalla e qarkullimit të ajrit dhe drejtimi i qarkullimit të ajrit). Sistemi NUK kontrollon temperaturën.

Informacion shtesë:

- **Temperatura jashtë.** Efekti ftohës ose ngrohës i sistemit ulet kur temperatura jashtë është shumë e lartë ose shumë e ulët.
- **Operimi i heqjes së ngricës.** Gjatë operimit të ngrohjes, mund të krijohet ngricë te njësia e jashtme dhe ulet kapaciteti i ngrohjes. Në atë rast, sistemi kalon automatikisht nga operimi i heqjes së heqjes së ngricës në heqjen e plotë të saj. Gjatë operimit të heqjes së ngricës, NUK lëshohet ajër i ngrohtë nga njësia e brendshme.

6.3.1 Fillimi/ndalja e modalitetit të operimit dhe caktimi i temperaturës



ON: Njësia po operon

: Gjendja e operimit = Automatik

: Gjendja e operimit = Tharje

: Gjendja e operimit = Ftohje

: Gjendja e operimit = Ngrohje

: Gjendja e operimit = Vetëm ventilator

88.8°C: Tregon temperaturën e caktuar.

1 Shtypni butonin Mode një ose disa herë për të zgjedhur gjendjen e operimit.

Rezultati: Gjendja do të caktohet sipas këtij rendi:



2 Shtypni ⏻ për **të filluar** përdorimin.

Rezultati: ON shfaqet në LCD. Llamba e treguesit të syrit Daikin ndryshon ngjyrë sipas operimit. Shikoni "4.1.1 Llamba e treguesit të syrit Daikin" [▸ 12].

3 Shtypni Temp ose Temp një ose disa herë për të ulur ose rritur**temperaturën**.

Operimi i ftohjes	Përdorimi i ngrohjes	Përdorimi automatik	Tharja ose përdorimi vetëm me ventilator
18~32°C	10~30°C	18~30°C	—

Shënim: Kur përdorni **tharjen** ose gjendjen **vetëm me ventilator**, nuk mund ta rregulloni temperaturën.

4 Shtypni ⏻ për **të ndaluar** përdorimin.

Rezultati: ON zhduket nga LCD. Llamba e treguesit të syrit Daikin fiket.

6.4 Shkalla e qarkullimit të ajrit

1 Shtypni për të zgjedhur:

	5 nivele të shkallës së qarkullimit të ajrit, nga "▬" deri në "▮"
A	Operimi automatik i qarkullimit të ajrit
	Operimi në qetësi i njësisë së brendshme. Kur qarkullimi i ajrit është caktuar në "", zhurma nga njësia do të reduktohet.

INFORMACION

- Nëse njësia arrin temperaturën e dëshiruar në modalitetin e ftohjes ose automatike, ventilatori ndalon së operuari
- Nëse njësia arrin temperaturën e dëshiruar në modalitetin e ngrohjes, ventilatori do të operojë në formën e ciklit me shpejtësi të ulët ventilatori.
- Kur përdorni operimin e tharjes, NUK MUND ta rregulloni cilësimin e shkallës së qarkullimit të ajrit.
- Shkalla e qarkullimit të ajrit në operimin automatik të shkallës së qarkullimit të ajrit caktohet sipas temperaturës së dhomës; në disa raste, mund të jetë më e ulët se operimi në qetësi i njësisë së brendshme. dhe nëse shkalla e qarkullimit të ajrit ndryshon në operimin në qetësi të njësisë së brendshme këtë herë, zhurma e operimit mund të jetë më e lartë.

6.4.1 Rregullimi i shkallës së qarkullimit të ajrit

1 Shtypni për të ndryshuar cilësimin e qarkullimit të ajrit si më poshtë:




6.5 Drejtimi i qarkullimit të ajrit

Kur. Rregulloni drejtimin e qarkullimit të ajrit sipas dëshirës.

Çfarë. Sistemi e drejton ndryshe qarkullimin e ajrit, në varësi të zgjedhjes së përdoruesit.

Cilësimi	Shfaq	Drejtimi i qarkullimit të ajrit
Lëkundja automatike vertikale		Pozicioni i lëkundjes ose i fiksuar i teheve horizontale (kapakët e xhepit).
Qarkullimi horizontal i ajrit	[—]	Pozicioni i teheve vertikale (frëngjitë) caktohet manualisht.



a Gama e lëvizjes së kapakëve të xhepit

KUJDES

- GJITHMONË përdorni një ndërfaqe përdoruesi (p.sh. telekomandë uajrles) për të rregulluar këndin e kapakut të xhepit. Kur kapaku i xhepit lëkundet dhe ju e lëvizni me dorë me forcë, mekanizmi prishet.
- Bëni kujdes kur rregulloni frëngjitë e ajrimit. Brenda pjesës së daljes së ajrit, ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë.

INFORMACION

Në lëkundjen automatike vertikale, kapakët e xhepit do të ndalojnë në pozicionin lart nëse shkalla e qarkullimit të ajrit dobësohet.

6.5.1 Rregullimi i drejtimit të qarkullimit vertikal të ajrit

1. Shtypni .

   Rezultati: shfaqet në LCD. Kapakët e xhepit (tehet horizontalë) do të fillojnë të lëkunden.


2. Për të përdorur pozicionin e fiksuar, shtypni kur kapakët e xhepit arrijnë pozicionin e dëshiruar.

   Rezultati: zhduket nga LCD. Kapakët e xhepit do të ndalojnë lëvizjen.

6.5.2 Rregullimi i frëngjive të ajrimit (tehet vertikale)

1. Rregulloni helikat horizontale duke përdorur ndërfaqen e përdoruesit (p.sh. telekomanda uajrles) që të mund të aksesoni lehtësisht dorezat në helikat vertikale.
2. Mbani dorezat dhe lëvizini ato ngadalë.

3 Rregulloni majtas ose djathtas në pozicionin e dëshiruar duke mbajtur dorezat.



INFORMACION

Kur njësia instalohet në një kënd të dhomës, drejtimi i frëngjive të ajrimit duhet të qëndrojnë larg murit. Efikasiteti bie nëse muri bllokon ajrin.

6.6 Kontrolli i Kompensimit të Klimës (CCC)

Përdorni këtë funksion për të kompensuar humbjet e nxehtësisë në shtëpi gjatë temperaturave të jashtme më të ftohta.

Përdorni këtë funksion në rast se ka një gjendje jokomode gjatë rënies së temperaturës së jashtme ambientale mes ditës/natës ose një ndryshimi të stinës së motit.

INFORMACION

- Ky funksion ul shpeshtësinë e rregullimeve të pikës së kontrollit të temperaturës për të arritur temperaturën e synuar në dhomë.
- Është e mundur të caktohen 4 nivele të ndryshme të intensitetit të kompensimit (LL, LH, HL, HH) ose fikni funksionin (oF).
- Sipas intensitetit të zgjedhur, njësia do të kompensojë temperaturën e jashtme të ambientit duke rritur vlerën e dëshiruar të temperaturës (temperaturë e ulët e dëshiruar e ambientit jashtë = rritje e madhe e vlerës së dëshiruar të temperaturës brenda).

Vendosja e modalitetit	Simboli	Cilësimi	Kontrolli i kompensimit të klimës është…
2	CCC	oF	…FIKUR, nuk ka kompensim
		LL	…NDEZUR, kompensim i ulët, kompensim i ulët në 0°C
		LH	…NDEZUR, kompensim i ulët, kompensim i lartë në 0°C
		HL	…NDEZUR, kompensim i lartë, kompensim i ulët në 0°C
		HH	…NDEZUR, kompensim i lartë, kompensim i lartë në 0°C

6.6.1 Fillimi/ndalimi i kontrollit të kompensimit të Klimës (CCC)

INFORMACION

Kontrolli i kompensimit të klimës mund të aktivizohet në modalitetin e operimit **të ngrohjes** "6.3 Gjendja e operimit dhe vlera e dëshiruar e temperaturës" [▶ 22].


Kontrolli i kompensimit të klimës mund të caktohet në çdo gjendje ambienti, por do të hyjë në fuqi kur temperatura e jashtme të bjerë nën +7°C.

1 Në ekranin e shtëpisë, shtypni Menu për të paktën 2 sekonda.

Rezultati: *1* vezullon.

2 Navigoni për te *CCC* cilësimi *2* me Select ose Select.

Rezultati: *2* vezullon.



3 Shtypni Menu për të futur cilësimin *CCC*.

Rezultati: Simboli i cilësimit (*oF*, *LL*, *LH*, *HL*, *HH*) po vezullon.

4 Ndryshoni cilësimin me Select ose Select sipas këtij rendi.



Rrisni vlerën e dëshiruar të temperaturës në dhomë sipas temperaturës së njësisë së jashtme				
Ambienti i jashtëm	**+7°C**	**0°C**	**–10°C**	**–25°C**
oF	0°C	0°C	0°C	0°C
LL	0°C	+0,5°C	+1°C	+2°C
LH	0°C	+1°C	+1,5°C	+2°C
HL	0°C	+1,5°C	+2°C	+4°C
HH	0°C	+2°C	+2°C	+4°C

5 Konfirmoni cilësimin me Menu

Rezultati: Cilësimi ka ndryshuar, je në menynë e cilësimit, *2* po vezullon.

Shënim: Ekrani do të kthehet automatikisht te monitori i shtëpisë pas 60 sekondave. Për t'u kthyer më shpejt te monitori i parazgjedhur, shtypni Cancel.

6.7 Kontakti i NDEZJES/FIKJES

Ky funksion kërkon blerjen dhe instalimin e opsionit KER303A.

Përdorni këtë funksion për të ndaluar automatikisht njësinë nga një sinjal i jashtëm i një kontakti të thatë (p.sh. sensori i dritares ose çelësi kartë i derës).

Ky funksion ndihmon të pakësojë konsumin e panevojshëm të energjisë kur dritarja ose dera është e hapur ose kur në dhomë nuk ka njerëz.

Njësia ndalon operimin në përputhje me statusin e kontaktit të jashtëm.

INFORMACION

Ky funksion përdor një kontakt të thatë dhe tufë telash, që duhen instaluar nga një instalues i kualifikuar.

- Koha e vonesës (**0** – cilësimi i fabrikës / 1 / 2 / 3 / 5 minuta) dhe modaliteti i rifillimit janë konfiguruar nga instaluesi sipas preferencave tuaja.
- Kur ky funksion është aktiv, mund ta parandalojë njësinë që të operojë edhe nëse i jepet një komandë operimi nga telekomanda ose aplikacioni ONECTA.

Sjellja kur kontakti i NDEZJES/FIKJES është aktiv

Kur aktivizohet funksioni i kontaktit të NDEZJES/FIKJES, sjellja e sistemit ndryshon sipas statusit të kontaktit.

Shembull (dritarja e mbyllur → dritarja e hapur)

- Kur dritarja është **e mbyllur**, njësia mund të operojë si zakonisht.
- Kur dritarja është **e hapur**, fillon kohëmatësi i vonesës.
- Pas kalimit të kohës së vonesës, njësia ndalon operimin dhe kalon në gatishmëri.
- Kur dritarja është e hapur:
  - Komanda e NDEZJES/FIKJES nga telekomanda ose aplikacioni ONECTA është e çaktivizuar.
  - Cilësimet e tjera, si **vlera e dëshiruar**, **modaliteti** ose **shpejtësia e ventilatorit**, mund të ndryshohen, por do të hyjnë në fuqi vetëm pas rifillimit të njësisë.

Cilësimi i modalitetit të rifillimit

Modaliteti i rifillimit përcakton se si njësia sillet pasi dritarja mbyllet sërish.

Rifillimi manual

- Njësia nuk rifillon automatikisht.
- Kur dritarja është e mbyllur, operimi duhet të niset manualisht duke shtypur komandën NDEZUR në telekomandë ose aplikacionin ONECTA.

Rifillimi automatik

- Njësia fillon automatikisht në modalitetin e fundit të operimit pas mbylljes së dritares.

Informacioni

- Nëse dëgjohen tre bipa dhe drita LED e operimit ndriçon dy herë, operimi bllokohet nga kontakti i NDEZJES/FIKJES.
- Pasi të mbyllet dritarja, njësia ose rifillon automatikisht ose mbetet e ndaluar, në varësi të modalitetit të zgjedhur të rifillimit.

NJOFTIM

Nëse doni të ndryshoni cilësimet (koha e vonesës ose modaliteti i rifillimit), kontaktoni instaluesin tuaj.

6.8 Preferenca për ajër të nxehtë

Përdorni këtë funksion për të pasur një përvojë më komode nxehjeje kur e caktoni ende manualisht shkallën e qarkullimit të ajrit.

INFORMACION

- Në modalitetin e ngrohjes, shkalla e qarkullimit të ajrit do të ulet përkohësisht për të parandaluar rrymat e ftohta. Me ngrohjen e ajrit, njësia do të vazhdojë të operojë me shkallën e përzgjedhur të qarkullimit të ajrit.
- Aktivizimi i këtij funksioni mund të reduktojë disi performancën e ngrohjes në kushte shumë të ftohta ose efikasitet më të ulët.

6.8.1 Nisja/ndalimi i preferencës për ajër të nxehtë

1 Në ekranin e shtëpisë, shtypni Menu për të paktën 2 sekonda.

Rezultati: Shfaqet menuja e cilësimit. *1* vezullon.

2 Shkoni te "Preferenca për ajër të nxehtë" – HAP cilësimi *3* duke shtypur Select ose Select.

Rezultati: *3* vezullon.


3 Shtypni Menu për të hyrë në cilësim.

Rezultati: Simboli i cilësimit (*on* ose *oF*) po vezullon.

- *oF* (cilësimi i fabrikës): funksioni është FIKUR
- *on*: funksioni është NDEZUR

4 Ndryshoni cilësimin *on* ↔ *oF* duke shtypur Select ose Select. Shtypni Menu për ta konfirmuar.

Rezultati: Cilësimi u konfirmua, je në menynë e cilësimit, *3* po vezullon.



Shënim: Ekrani do të kthehet automatikisht te monitori i shtëpisë pas 60 sekondave. Për t'u kthyer më shpejt te monitori i parazgjedhur, shtypni Cancel.

6.9 Kufiri i temperaturës

Ky funksion është i dizajnuar të kufizojë vlerën e dëshiruar të temperaturës që të mund të zgjidhni, duke ndihmuar në uljen e konsumit të energjisë dhe shmangien e mbiftohjes ose mbinxehjes së panevojshme.

INFORMACION

- Kufiri i temperaturës përcakton vlerat e dëshiruara të ftohjes minimale dhe ngrohjes maksimale që mund të vendosen duke përdorur telekomandën uajrles ose aplikacionin ONECTA.
- Kufijtë konfigurohen veçmas për telekomandën uajrles dhe aplikacionin ONECTA.
- Sapo të vendosen kufijtë, si vlerat e dëshiruara të ngrohjes, ftohjes dhe ato automatike do të kufizohen në përputhje me to.

Sjellja kur kufiri i temperaturës është aktiv

Kur funksioni i kufizimit të temperaturës është i aktivizuar, sjellja e sistemit ndryshon për të garantuar operim konsistent brenda kufijve të përcaktuar.

Shembull:

- Nëse kufiri i poshtëm i ftohjes është i vendosur në **20°C**, diapazoni i vlerës së dëshiruar të ftohjes do të jetë **20–32°C**.

- Nëse kufiri i sipërm i ngrohjes është i vendosur në **28°C**, diapazoni i vlerës së dëshiruar të ngrohjes do të jetë **10–28°C**.
- Në **modalitetin Automatik**, diapazoni i vlerës së dëshiruar do të jetë **20–28°C**.

Cilësimet me parazgjedhje të fabrikës:

- Kufiri i poshtëm i ftohjes: 18°C
- Kufiri i sipërm i ngrohjes: 30°C

INFORMACION


- Funksioni i kufirit të temperaturës nuk mund të çaktivizohet plotësisht. Megjithatë, rikthimi i kufijve në vlerat e paracaktuara të fabrikës lejon operim të pakufizuar brenda diapazonit të plotë të vlerës së dëshiruar të njësisë.
- Për operim të përshtatshëm, sigurohuni që të njëjtët kufij të temperaturës të jeni konfiguruar si në telekomandë ashtu edhe në aplikacionin ONECTA.
- Në varësi të kufijve të zgjedhur të temperaturës, kapaciteti ngrohës ose ftohës i njësisë mund të reduktohet për shkak të diapazonit të kufizuar të vlerës së dëshiruar.

6.9.1 Caktimi i kufirit të temperaturës

1 Shtypni Temp + Mode për të hyrë në cilësim.

Rezultati: Shfaqet cilësimi SC 001.

2 Përdorni Temp për të shkuar te LS (cilësimi i kufirit të temperaturës) 005.



3 Shtypni Mode për të hyrë në cilësimin e kufirit të temperaturës.

Rezultati: Shfaqet cilësimi ❄ për kufirin e poshtëm të ftohjes.


4 Përdorni Temp për të zgjedhur kufirin e dëshiruar të poshtëm të ftohjes.

5 Shtypni Mode për të konfirmuar dhe kaluar në cilësimin ☀ e kufirit të sipërm të ngrohjes.

6 Përdorni Temp për të zgjedhur temperaturën e dëshiruar të kufirit të sipërm të ngrohjes.

7 Shtypni Mode për të konfirmuar dhe për të dalë nga modaliteti i cilësimit të diapazonit të temperaturës, ndërkohë duke drejtuar nga njësia e brendshme.

Rezultati: Konfirmohet kufiri i poshtëm për ftohje dhe kufiri i sipërm për ngrohje. Ekrani kthehet te menuja e cilësimit.






Shënim: Ekrani do të kthehet automatikisht te monitori i shtëpisë pas 60 sekondave nga pasiviteti. Për të dalë më herët, shtypni Cancel.

Shënim: Nëse kalojnë më tepër se 60 sekonda pas cilësimit të kufirit të ftohjes, do të rikuperohet vlera origjinale e ftohjes dhe cilësimi i kufirit të ngrohjes nuk do të zbatohet.

6.10 Zgjedhja e daljes së ajrit

Përdorni këtë funksion për ta lënë njësinë të vendosë automatikisht se cila dalje e ajrit duhet të përdoret ose caktoni vetëm daljen e sipërme të ajrit. Cilësimi automatik është zgjedhja automatike e daljes së ajrit.

Cilësimi	Shfaq	Drejtimi i qarkullimit të ajrit
Zgjedhja automatike e daljes së ajrit		Njësia vendos automatikisht daljen më të mirë të ajrit në varësi të modalitetit të operimit ose kushteve të dhomës.
Vetëm dalja e sipërme e ajrit		Qarkullimi i ajrit është vendosur në daljen e sipërme të ajrit, pavarësisht modalitetit të operimit ose kushteve të dhomës.

Cilësimi	Modaliteti i operimit	Situata	Zgjedhja e daljes së ajrit
	**Tharja**	Çdo situatë	
	Ftohja	Kur temperatura e dhomës arrin vlerën e dëshiruar ose koha totale e operimit në lagështi të lartë arrin 1 orë.	
		Kur temperatura e dëshiruar NUK arrihet ende, ose koha totale e operimit në lagështi të lartë është më e vogël se 1 orë.	
	Ngrohje, vetëm ventilator	Çdo situatë	
	**Tharje, ftohje, ngrohje, vetëm ventilator**	Çdo situatë	

INFORMACION

- Gjatë operimit të tharjes qarkullimi i ajrit vjen vetëm nga dalja e sipërme e ajrit. Shikoni "6.3 Gjendja e operimit dhe vlera e dëshiruar e temperaturës" [▸ 22] për vendosje.
- Gjatë operimit të ngrohjes së dyshemesë, qarkullimi i ajrit vjen vetëm nga dalja e poshtme e ajrit. Shikoni "6.12 Operimi i ngrohjes së dyshemesë" [▸ 32] për vendosje. Ngrohja e dyshemesë mund të vendoset vetëm me cilësimin e zgjedhjes automatike të daljes së ajrit.
- Nëse ndryshoni cilësimin nga zgjedhja automatike e daljes së ajrit në daljen e sipërme e ajrit vetëm në operimin me ngrohje, ngrohja ndërpritet përkohësisht për të mbrojtur njësinë.
- Aftësia për ftohje/ngrohje është më e ulët kur është caktuar vetëm dalja e sipërme e ajrit.
- Ndërkohë që zgjedhja e daljes së ajrit po ndryshon, mund të dëgjohet një zhurmë nga amortizuesi lëvizës.


6.10.1 Vendosja e zgjedhjes automatike të daljes së ajrit ose vetëm dalja e sipërme e ajrit

Kushti paraprak: Cilësimi automatik është zgjedhja automatike e daljes së ajrit.

1. Në ekranin e shtëpisë, shtypni [Menu] për të paktën 2 sekonda.

   Rezultati: Shfaqet menyja e zgjedhjes. Numri i menysë po vezullon.


2. Shtypni [Select] ose [Select] për të zgjedhur numrin e menysë 4.



3. Shtypni [Menu] për të hyrë në cilësim.

   Rezultati: "A" po vezullon.

4. Shtypni [Select] ose [Select] për të ndryshuar cilësimin. "A" = **zgjedhja automatike e daljes së ajrit** ose "1" = **vetëm dalja e sipërme e ajrit**.



5. Shtypni [Menu] për të konfirmuar cilësimin e zgjedhur.

   Rezultati: Cilësimi ka ndryshuar.

Shënim: Ekrani do të kthehet automatikisht te monitori i parazgjedhur pas 1 minute. Për tu kthyer tek monitori i parazgjedhur shtypni dy herë [Cancel].

6.11 Cilësimi i ventilatorit të njësisë së brendshme kur termostati është i fikur në ftohje

Kur njësia të arrijë vlerën e dëshiruar të temperaturës gjatë operimit të ftohjes, ventilatori do të kalojë në FIKUR për të shmangur rritjen e lagështisë së dhomës. Nëse doni ta mbani ventilatorin në punë, aktivizoni ventilatorin në ON.

6.11.1 Kontrollimi i ventilatorit të njësisë së brendshme kur termostati është i fikur në ftohje


1. Në ekranin e shtëpisë, shtypni [Menu] për të paktën 2 sekonda.

   Rezultati: Shfaqet menyja e zgjedhjes. Numri i menysë po vezullon.

2. Shtypni [Select] ose [Select] për të zgjedhur numrin e menysë 5.

3. Shtypni [Menu] për të hyrë në cilësim.

   Rezultati: oF po vezullon.



4. Shtypni [Select] ose [Select] për të ndryshuar cilësimin.



Vezullon	Cilësimi i ventilatorit	Rezultati
oF	Fikur	Ventilatori ndalon pasi njësia të ketë arritur vlerën e dëshiruar të temperaturës në operimin e ftohjes.
on	Ndezur	Ventilatori punon edhe pasi njësia të ketë arritur vlerën e dëshiruar të temperaturës në operimin e ftohjes.


5 Shtypni Menu për të konfirmuar cilësimin e zgjedhur.

Shënim: Ekrani do të kthehet automatikisht te monitori i parazgjedhur pas 1 minute. Për t'u kthyer më shpejt te monitori i parazgjedhur, shtypni Cancel.


6.12 Operimi i ngrohjes së dyshemesë

Ky operim mund të ngrohë në mënyrë efikase zona të mëdha dyshemeje duke mbyllur daljen e sipërme të ajrit dhe duke rritur shpejtësinë e ajrit të arrijë sipërfaqe të largëta të dyshemesë.

Operimi normal



Operimi i ngrohjes së dyshemesë



INFORMACION

- Operimi i ngrohjes së dyshemesë mund të përdoret në modalitetin e operimit vetëm me ngrohje dhe me cilësimin e zgjedhjes automatike të daljes së ajrit.
- Nëse temperatura e dhomës është e ulët, dhoma mund të mos ngrohet mjaftueshëm.

6.12.1 Fillimi/ndalimi i operimit të ngrohjes së dyshemesë

Kushti paraprak: Ky operim mund të vendoset vetëm në modalitetin e operimit të ngrohjes dhe me cilësimin e zgjedhja automatike të daljes së ajrit.

1 Shtypni .

Rezultati: shfaqet në LCD dhe operimi fillon.

2 Për të ndaluar operimin, shtypni .

Rezultati: zhduket nga LCD dhe operimi ndalon.

6.13 Operimi i fuqishëm dhe ngrohje plus

6.13.1 Operimi i fuqishëm

Ky operim maksimizon shpejt efektin e ftohjes/ngrohjes në çdo gjendje operimi. Mund të merrni kapacitetin maksimal.

Modaliteti	Shkalla e qarkullimit të ajrit
Ftohje/Ngrohje	▪ Për të maksimizuar efektin e ftohjes/ngrohjes, rritet kapaciteti i njësisë së jashtme. ▪ Shkalla e qarkullimit të ajrit fiksohet në cilësimin maksimal. ▪ Cilësimet e temperaturës dhe qarkullimit të ajrit NUK MUND të ndryshohen.
Tharja	▪ Cilësimi i temperaturës ulet me 2,5°C. ▪ Shkalla e qarkullimit të ajrit rritet në mënyrë të ndjeshme.
Vetëm me ventilator	Shkalla e qarkullimit të ajrit fiksohet në cilësimin maksimal.

INFORMACION

- Operimi i fuqishëm nuk mund të përdoret së bashku me operimin ngrohje plus, ngrohja e dyshemesë, ekonomik dhe operimi i njësisë së jashtme në gjendje qetësie. Përparësi merr funksioni i zgjedhur në fund.
- Operimi i fuqishëm NUK do të rrisë kapacitetin e njësisë, nëse operon me kapacitet maksimal.

6.13.2 Operimi ngrohje plus

Ky operim rrit temperaturën e qarkullimit të ajrit që vjen nga njësia. Temperatura e qarkullimit të ajrit është më e lartë se gjatë operimit normal të ngrohjes. Përdorni këtë operim kur doni të ndjeni më shumë ngrohje. Ky operim ka një kohëzgjatje 30 minuta.

INFORMACION

- Operimi ngrohje plus mund të përdoret në modalitetin vetëm me ngrohje.
- Nëse temperatura e dhomës është e ulët, dhoma mund të mos ngrohet mjaftueshëm.
- MOS qëndroni afër për një kohë të gjatë me daljen e ajrit dhe drejtpërdrejt me ajrin e shkarkuar.
- Pasi të mbarojë operimi NGROHJE PLUS, në varësi të temperaturës së vendosur për operimin NGROHJE, energjia mund të pakësohet përkohësisht.
- Në lidhjen e sistemit me shumë njësi, temperatura e qarkullimit të ajrit mund të jetë e pamjaftueshme.

6.13.3 Fillimi/ndalimi i operimit të fuqishëm dhe ngrohje plus

1 Shtypni  një ose disa herë për të zgjedhur operimin.

Rezultati: Cilësimi do të ndryshohet sipas rendit vijues.



Shfaq	Operimi
	I fuqishëm
	Ngrohje plus
—	Të dyja të çaktivizuara

- Operimi i fuqishëm vazhdon për 20 minuta; pas kësaj, operimi i kthehet gjendjes së caktuar më parë.
- Operimi ngrohje plus vazhdon për 30 minuta; pas kësaj, operimi i kthehet gjendjes së caktuar më parë.

2 Për të ndalur operimin shtypni derisa të dy simbolet të zhduken nga ekrani LCD.

Shënim: Operimi i fuqishëm dhe ngrohje plus mund të caktohet vetëm kur njësia është në punë. Nëse shtypni , operimi do të anulohet; dhe zhduket nga LCD.


6.14 Butoni i përdorimit të qetë dhe ekonomik të njësisë së jashtme

6.14.1 Operimi ekono

Ky është një funksion që mundëson operimin efikas duke kufizuar vlerën maksimale të konsumit të energjisë. Ky funksion është i dobishëm për rastet kur duhet të kushtohet vëmendje për të garantuar që një çelës dritash nuk pengohet kur produkti kalon nga aparaturat e tjera.

INFORMACION

- Operimi i fuqishëm, ngrohje plus, ngrohja e dyshemesë dhe operimi ekonomik NUK MUND të përdoren në të njëjtën kohë. Përparësi merr funksioni i zgjedhur në fund.
- Operimi ekonomik disponohet vetëm në modalitetet automatike, të ftohjes, ngrohjes dhe tharjes.
- Operimi Ekono ul konsumin e energjisë të njësisë së jashtme duke kufizuar shpejtësinë rrotulluese të kompresorit. Nëse konsumi i energjisë është i ulët, operimi Ekono NUK do të reduktojë më tej konsumin e energjisë.



A Vënia në punë e rrymës dhe konsumit të energjisë
B Ora
a Maksimumi gjatë operimit normal
b Maksimumi gjatë përdorimit ekono
c Operimi normal
d Operimi ekono

- Diagrami është vetëm për qëllime ilustruese.
- Rryma maksimale dhe konsumi i energjisë të kondicionerit në operimin Ekono ndryshon me njësinë e jashtme.

6.14.2 Operimi në qetësi i njësisë së jashtme

Përdorni operimin në gjendje qetësie të njësisë së jashtme kur doni të ulni nivelin e zhurmës së njësisë së jashtme. **Shembull:** Natën.

INFORMACION

- Operimi i fuqishëm, ngrohje plus, ngrohja e dyshemesë dhe operimi i njësisë së jashtme në gjendje qetësie NUK MUND të përdoren në të njëjtën kohë. Përparësi merr funksioni i zgjedhur në fund.
- Operimi në qetësi i njësisë së jashtme disponohet vetëm në operimin automatik, të ftohjes dhe ngrohjes.
- Përdorimi në qetësi i njësisë së jashtme kufizon shpejtësinë e rrotullimit të kompresorit. Nëse shpejtësia e rrotullimit të kompresorit është e ulët, përdorimi i pushimit të njësisë së jashtme NUK ul më shpejtësinë e rrotullimit të kompresorit.

6.14.3 Fillimi/ndalimi i përdorimit të qetë dhe ekonomik të njësisë së jashtme

1 Shtypni (Eco/Outdoor unit) një ose disa herë.

Rezultati: Cilësimi do të ndryshojë si vijon.



Ekrani	Operimi
(Eco)	Ekono
(Outdoor unit)	Njësia e jashtme në gjendje të qetë
(Eco + Outdoor unit)	Butoni i përdorimit të qetë dhe ekonomik të njësisë së jashtme
—	Të dyja të çaktivizuara

2 Për të ndalur operimin, shtypni (Eco/Outdoor unit) derisa të dy simbolet të zhduken nga ekrani LCD.

Shënim: Operimi ekonomik mund të caktohet vetëm kur njësia është në punë. Shtypja e (On/Off) anulon cilësimin dhe (Eco) zhduket nga ekrani LCD.

Shënim: (Outdoor unit) mbetet në LCD edhe nëse fikni njësinë duke përdorur telekomandën uajrles ose çelësin ON/OFF të njësisë së brendshme.

6.15 Operimi i Flash Streamer (pastrimi i ajrit)

INFORMACION

- Elektronet e shpejtësisë së lartë lindin dhe largohen brenda njësisë për të garantuar një përdorim të sigurt.
- Shkarkuesi i Streamer mund të nxjerrë një zhurmë vërshëllyese.
- Nëse qarkullimi i ajrit bëhet i dobët, shkarkuesi i Streamer mund të ndalojë përkohësisht për të parandaluar erën e ozonit.

6.15.1 Nisja/ndalimi i operimit të Flash Streamer (pastrimi i ajrit)

Kushti paraprak: Kontrolloni që njësia po operon (ON shfaqet në ekranin LCD të telekomandës uajrles).

1 Shtypni (Flash Streamer).

Rezultati: shfaqet në LCD dhe ajri në dhomë pastrohet kur njësia po operon.

2 Për të ndaluar operimin, shtypni (Flash Streamer).

Rezultati: zhduket nga LCD dhe operimi ndalon.

INFORMACION

- Mund të caktoni operimin e Flash Streamer kur njësia është e NDEZUR ose e FIKUR, por operimi fillon vetëm njësia është në përdorim.
- Kur të mbarojë rregullimi ndërkohë që njësia NUK është në përdorim, shfaqet në ekranin LCD të telekomandës uajrles, por operimi NUK fillon.

6.16 Operimi i kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES

Funksionet e kohëmatësit janë të dobishme për kalimin në mënyrë automatike të ndezjes/fikjes së kondicionerit natën ose në mëngjes. Ju mund të përdorni në kombinim FIKJEN dhe NDEZJEN e kohëmatësit.

Ka dy lloje cilësimesh të kohëmatësit të FIKJES/NDEZJES:

- **Kohëmatësi i FIKJES/NDEZJES 24 orësh** (i paracaktuar). Njësia do të ndalojë/fillojë operimin në kohën e caktuar. **Shembull:** Kohëmatësi i NDEZJES është i caktuar në 13:30, njësia do të fillojë operimin në 13:30.
- **Kohëmatësi i FIKJES/NDEZJES me numërim mbrapsht 12 orësh.** Njësia do të ndalojë/fillojë operimin pas numrit të caktuar të orëve. **Shembull:** Kohëmatësi i NDEZJES është i caktuar në 10:30 për 3 orë, njësia do të fillojë operimin në në 13:30.

Shënim: Kombinimi i të dy llojeve të cilësimit të kohëmatësit është i mundur.

INFORMACION

Programoni sërish kohëmatësin në rast se:

- Një çelës e ka fikur njësinë.
- Avari e energjisë.
- Pas ndërrimit të baterive te telekomanda uajrles.

INFORMACION


Ora DUHET të caktohet si duhet para përdorimit të funksioneve të kohëmatësit. Referojuni "5.5.1 Caktimi i orës" [▸ 18].

6.16.1 Cilësimi i kohëmatësit të FIKJES/NDEZJES 24 orësh

Fillimi/ndalimi i operimit të FIKJES së kohëmatësit

1 Shtypni Off për të filluar.

Rezultati: 0:00 shfaqet në LCD dhe OFF vezullon. ⏲ dhe dita e javës zhduket nga LCD.



2 Shtypni Select ose Select për të ndryshuar cilësimin e orës.

3 Shtypni Off sërish.

Rezultati: OFF dhe ora e caktuar shfaqet në LCD. Syri Daikin ndez dritën portokalli.

INFORMACION

Çdo herë që shtypet Select ose Select, cilësimi i orës përparon me 10 minuta. Mbajtja e butonit poshtë ndryshon shpejt cilësimin.


4 Për ta anuluar cilësimin e kohëmatësit, shtypni [Cancel].

Rezultati: Koha e caktuar dhe OFF zhduken nga ekrani LCD. ⏲ dhe dita e javës shfaqen në LCD. Syri Daikin ndalon ndezjen e dritës portokalli.

Fillimi/ndalimi i operimit të NDEZJES së kohëmatësit

1 Shtypni [On] për të filluar.

Rezultati: 6:00 shfaqet në LCD dhe ON vezullon. ⏲ dhe dita e javës zhduket nga LCD.



2 Shtypni [Select ▲] ose [Select ▼] për të ndryshuar cilësimin e orës.

3 Shtypni [On] sërish.

Rezultati: ON dhe ora e caktuar shfaqet në LCD. Syri Daikin ndez dritën portokalli.

> **INFORMACION**
>
> Çdo herë që shtypet [Select ▲] ose [Select ▼], cilësimi i orës përparon me 10 minuta. Mbajtja e butonit poshtë ndryshon shpejt cilësimin.

4 Për ta anuluar cilësimin e kohëmatësit, shtypni [Cancel].


Rezultati: Koha e caktuar dhe ON zhduken nga ekrani LCD. ⏲ dhe dita e javës shfaqen në LCD. Syri Daikin ndalon ndezjen e dritës portokalli.

Kombinimi i kohëmatësit të FIKJES dhe NDEZJES

1 Për të caktuar kohëmatësit, referojuni "Fillimi/ndalimi i operimit të FIKJES së kohëmatësit" [▸ 36] dhe "Fillimi/ndalimi i operimit të NDEZJES së kohëmatësit" [▸ 37].

Rezultati: OFF dhe ON shfaqen në LCD.

Shembull:

Ekrani	Ora aktuale	Caktoni kur…	Përdorimi
	6:00	njësia është në përdorim.	Ndalon në 7:00 dhe pastaj fillon në 14:00.
		njësia NUK është në përdorim.	Fillon në orën 14:00.


Shënim: Nëse cilësimi i orës është aktiv, ora aktuale NUK shfaqet në LCD.

6.16.2 Cilësimi i kohëmatësit të FIKJES/NDEZJES me numërim mbrapsht 12 orësh

Fillimi/ndalimi i operimit të kohëmatësit të FIKJES/ FIKJES me numërim mbrapsht

1 Shtypni dhe mbani shtypur [Off] ose [On] për rreth 5 sekonda; kur ▲ vezullon, lëshoni butonin.

Rezultati:



Për kohëmatësin e FIKJES, 1hr shfaqet në LCD dhe OFF vezullon, ⏲ dhe dita e javës zhduket nga LCD.



Për kohëmatësin e NDEZJES, 1hr shfaqet në LCD dhe ON vezullon. ⏲ dhe dita e javës zhduket nga LCD.

2 Shtypni [Select] ose [Select] për të ndryshuar cilësimin e orës. Ora mund të caktohet nga 1~12 orë. Secila shtypje e butonit rrit ose ul cilësimin e orës me 1 orë.

3 Shtypni [Off] ose [On] për të konfirmuar cilësimin.

Rezultati: OFF dhe/ose ON dhe koha e vendosur shfaqen në LCD. Daikin Eye ndriçon portokalli. Koha e shfaqur në LCD do të numërojë automatikisht mbrapsht me 1 orë për çdo orë që kalon.

Shembull: Nëse kohëmatësi i FIKJES është i vendosur në 3 orë, koha e shfaqur do të ndryshojë si vijon: 3orë → 2orë → 1orë → bosh (FIKUR)

4 Për ta ndryshuar sërish cilësimin në kohëmatësin e FIKJES/NDEZJES 24 orësh, përsëritni hapin 1 kur jeni në ekranin kryesor kur OFF dhe/ose ON NUK po vezullojnë.

5 Për ta anuluar cilësimin e kohëmatësit, shtypni [Cancel].

Kombinimi i modaliteteve të ekranit të kohëmatësit

Modalitetet e ndryshme të ekranit (kohëmatësi i FIKJES/NDEZJES me numërim mbrapsht 24 orë dhe 12 orë) mund të përdoren për kohëmatësin e FIKJES dhe të NDEZJES njëkohësisht.

1 Për cilësimin, shikoni "Fillimi/ndalimi i operimit të FIKJES së kohëmatësit" [▸ 36], "Fillimi/ndalimi i operimit të NDEZJES së kohëmatësit" [▸ 37] dhe "Fillimi/ndalimi i operimit të kohëmatësit të FIKJES/NDEZJES me numërim mbrapsht" [▸ 37].

Shembull:

Shfaq	Ora aktuale	Caktoni kur…	Operimi
	22:00	njësia është në përdorim.	▪ Ndalon në 1:00 (3 orë pas kohës aktuale) ▪ Fillon në orën 6:00. (8 orë pas kohës aktuale)
			
			

Shënim: Nëse cilësimi i orës është aktiv, ora aktuale NUK shfaqet në LCD.

6.17 Operimi i kohëmatësit javor

INFORMACION




Mos përdorni cilësimin e kohëmatësit Javor njëkohësisht me kohëmatësin e planifikimit të aplikacionit ONECTA. Të dyja cilësimet janë të pavarur nga njëra-tjetra. Përdorni vetëm njërin prej tyre.

INFORMACION

Procedura e mëposhtme e cilësimit është vetëm për telekomandën uajrles. Megjithatë, ne rekomandojmë të kryeni cilësimin javor të kohëmatësit duke përdorur aplikacionin ONECTA. Referojuni "6.18 Lidhje uajrles LAN" [▸ 42] për më shumë informacion.

Me këtë përdorim ju mund të kurseni deri në 4 cilësime të kohëmatësit për çdo ditë të javës.

Shembull: Krijoni një cilësim ndryshe nga e hëna në të premte dhe cilësim tjetër për fundjavat.

Dita e javës	Shembull cilësimi
E hënë ▪ Krijoni deri në 4 cilësime.	
E martë~E premte ▪ Përdorni gjendjen e kopjimit nëse cilësimet janë njësoj edhe për të hënën.	
E shtunë ▪ Nuk ka cilësim kohëmatësi	—
E diel ▪ Krijoni deri në 4 cilësime.	

- **Cilësimi NDEZUR-NDEZUR-NDEZUR-NDEZUR.** Aktivizon programimin e gjendjes së operimit dhe cakton temperaturën.
- **Cilësimi FIKUR-FIKUR-FIKUR-FIKUR.** Vetëm koha e fikjes mund të caktohet çdo ditë.

Shënim: Sigurohuni që telekomandën uajrles ta drejtoni nga njësia e brendshme dhe të kontrolloni për një tingull kur vendosni cilësimin e operimit të kohëmatësit javor.

INFORMACION

Ora DUHET të caktohet si duhet para përdorimit të funksioneve të kohëmatësit. Referojuni "5.5.1 Caktimi i orës" [▶ 18].

INFORMACION

- Operimi i kohëmatësit javor dhe operimi i FIKJES/NDEZJES NUK MUND të përdoren në të njëjtën kohë. Operimi i kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES ka përparësi. Kohëmatësi javor do të jetë në gjendje gatishmërie, WEEKLY zhduket nga LCD. Kur mbaron kohëmatësi i NDEZJES/FIKJES, kohëmatësi Javor bëhet aktiv.
- Dita e javës, gjendja e kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES, ora dhe temperatura (vetëm për kohëmatësin e NDEZJES) mund të caktohen me kohëmatësin javor. Cilësimet e tjera bazohet në cilësimin e mëparshëm të kohëmatësit të NDEZJES.

6.17.1 Caktimi i operimit të kohëmatësit javor

1 Shtypni .


Rezultati: Shfaqet dita e javës dhe numri i rezervimit të ditës aktuale.



2 Shtypni ose për të zgjedhur ditën e javës dhe numrin e rezervimit.


3 Shtypni Next.

Rezultati: Dita e javës është e caktuar. WEEKLY dhe ON vezullon.



4 Shtypni ose për të zgjedhur modalitetin.

Rezultati: Cilësimi do të ndryshojë si vijon:



Ekrani	Funksioni
ON	Kohëmatësi i NDEZJES
OFF	Kohëmatësi i FIKJES
Bosh	Fshin rezervimin

5 Shtypni Next.

Rezultati: Gjendja e kohëmatësit të NDEZJES/FIKJES është vendosur. WEEKLY dhe ora vezullon.



Shënim: Shtypni Back nëse doni të ktheheni tek ekrani i mëparshëm. Nëse zgjidhet bosh, vazhdoni direkt te hapi 9.

6 Shtypni Select ose Select për të zgjedhur orën. Ora mund të caktohet mes 0:00~23:50 me intervale 10 minuta.

7 Shtypni Next.

Rezultati: Ora është caktuar dhe WEEKLY temperatura vezullon.



Shënim: Shtypni Back nëse doni të ktheheni tek ekrani i mëparshëm. Nëse zgjidhet kohëmatësi i FIKJES, vazhdoni direkt te hapi 9.

8 Shtypni Select ose Select për të zgjedhur temperaturën e dëshiruar.

Shënim: Temperatura e caktuar për kohëmatësin javor shfaqet vetëm kur caktohet gjendja e tij.

INFORMACION

Temperatura mund të caktohet nga 10~32°C në telekomandën uajrles, megjithatë:

- në modalitetin e ftohjes dhe operimit automatik, njësia do të operojë minimumi në 18°C, edhe nëse është caktuar në 10~17°C;
- në modalitetin e ngrohjes dhe operimit automatik, njësia do të operojë maksimumi në 30°C, edhe nëse është caktuar në 31~32°C.

9 Shtypni Next.

Rezultati: Temperatura dhe ora janë caktuar për kohëmatësin e NDEZJES. Koha është e caktuar për kohëmatësin e FIKJES. Syri Daikin ndez dritën portokalli.

Rezultati: Do të shfaqet ekrani i rezervimit të ri.

10 Përsërisni procedurën e mëparshme për të caktuar një rezervim tjetër ose shtypni për të përfunduar cilësimin.

Rezultati: WEEKLY shfaqet në LCD.

Shënim: Rezervimi mund të kopjohet me të njëjtat cilësime në një ditë tjetër. Referojuni "6.17.2 Kopjimi i rezervimeve" [▸ 40].

6.17.2 Kopjimi i rezervimeve


Rezervimi mund të kopjohet për ditën tjetër. I gjithë rezervimi i ditës së zgjedhur të javës do të kopjohet.

1 Shtypni [◈].

2 Shtypni [Select ▲] ose [Select ▼] për të zgjedhur javën për tu kopjuar.

3 Shtypni [Copy].


Rezultati: I gjithë rezervimi i ditës së zgjedhur të javës do të kopjohet.



4 Shtypni [Select ▲] ose [Select ▼] për të zgjedhur ditën e destinuar të javës.

5 Shtypni [Copy].

Rezultati: I gjithë rezervimi kopjohet te dita e zgjedhur dhe llamba e syrit Daikin ndriçon portokallinë.



Shënim: Për të kopjuar te dita tjetër, përsërisni procedurën.

6 Shtypni [◈] për të përfunduar cilësimin.

Rezultati: WEEKLY shfaqet në LCD.

Shënim: Për të ndryshuar cilësimin e rezervimit pas kopjimit, referojuni "6.17.1 Caktimi i operimit të kohëmatësit javor" [▸ 39].

6.17.3 Konfirmimi i rezervimeve

Ju mund të konfirmoni nëse të gjitha rezervimet janë caktuar sipas nevojave tuaja.

1 Shtypni [◈].

Rezultati: Shfaqet dita e javës dhe numri i rezervimit të ditës aktuale.



2 Shtypni [Select ▼] ose [Select ▲] për të zgjedhur ditën e javës dhe numrin e rezervimit për tu konfirmuar dhe shikoni detajet e rezervimit.

Shënim: Për të ndryshuar cilësimin e rezervimit, referojuni "6.17.1 Caktimi i operimit të kohëmatësit javor" [▸ 39].

3 Shtypni [◈] për të dalë nga gjendja e konfirmimit.

6.17.4 Për të çaktivizuar dhe riaktivizuar operimin e kohëmatësit javor

1 Për të çaktivizuar cilësimin javor, shtypni [Weekly] kur është i shfaqur WEEKLY në LCD.

Rezultati: WEEKLY zhduket nga ekrani LCD dhe syri Daikin ndalon dritën portokalli.

2 Për të riaktivizuar kohëmatësin javor shtypni sërish [Weekly].

Rezultati: Do të përdoret gjendja e fundit e rezervimit të caktuar.

6.17.5 Fshirja e rezervimeve

Fshirja e rezervimit individual

Përdorni këtë funksion nëse doni të fshini një cilësim të vetëm rezervimi.

1 Shtypni [◈].

Rezultati: Shfaqet dita e javës dhe numri i rezervimit.


2 Shtypni [Select] ose [Select] për të zgjedhur ditën e javës për tu fshirë.

3 Shtypni [Next].

Rezultati: WEEKLY, ON dhe OFF vezullon.

4 Shtypni [Select] ose [Select] dhe zgjidhni "bosh".

Rezultati: Cilësimi do të ndryshohet sipas rendit vijues:



5 Shtypni [Next].

Rezultati: Rezervimi i zgjedhur u fshi.

6 Shtypni [◈] për të dalë.

Rezultati: Rezervimet e mbetura janë aktive.

Fshirja e rezervimit për secilën ditë të javës

Përdorni këtë funksion nëse doni të fshini të gjitha cilësimet e rezervimit për një ditë të javës. Mund të përdoret në konfirmimin ose caktimin e gjendjes.

1 Shtypni [◈].

2 Shtypni [Select] ose [Select] për të zgjedhur ditën e javës për tu fshirë.

3 Mbani shtypur [Weekly] për rreth 5 sekonda.

Rezultati: Të gjitha rezervimet për ditën e zgjedhur janë të fshira.

4 Shtypni [◈] për të dalë.

Rezultati: Rezervimet e mbetura janë aktive.

Fshirja e të gjitha rezervimeve

Përdorni këtë funksion nëse doni ti fshini njëherësh të gjitha rezervimet për të gjitha ditët e javës. Kjo procedurë NUK MUND të përdoret te gjendja e cilësimit.

1 Mbajeni [Weekly] për rreth 5 sekonda kur të jetë në ekranin e parazgjedhur.


Rezultati: Të gjitha rezervimet do të fshihen.

6.18 Lidhje uajrles LAN

Klienti mban përgjegjësi për të ofruar:

- Telefon inteligjent ose tablet me versionin minimal të mbështetur të Android ose iOS, përcaktuar në app.daikineurope.com.
- Linjë interneti dhe pajisje komunikimi si modem, ruter etj.
- Pikë aksesi linje LAN uajrles
- Aplikacion i instaluar falas ONECTA

Shënim: Nëse nevojitet, numri SSID dhe ÇELËSI gjenden te njësia. Njësia dërgohet me një ngjitëse shtesë me numrin SSID dhe fjalëkalim, që ngjiten në veshjen e jashtme.



a Etiketa me numrin SSID, fjalëkalimi dhe çelësi
b Etiketa shtesë me numrin SSID, fjalëkalimi dhe çelësi

6.18.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë

MOS e përdorni afër:

- **Pajisjeve mjekësore.** P.sh. personave që përdorin stimulues kardiakë ose defibrilatorë. Ky produkt mund të shkaktojë interferencë elektromagnetike.
- **Pajisjeve me kontroll automatik.** P.sh. dyerve automatike ose pajisjeve të alarmit të zjarrit. Ky produkt mund të shkaktojë defekte të pajisjes.
- **Mikrovalës.** Mund të ndikojë te komunikimet uajrles LAN.

6.18.2 Instalimi i aplikacionit ONECTA

1. Shkoni te Google Play (për pajisjet Android) ose App Store (për pajisjet iOS) dhe kërkoni "ONECTA".
2. Ndiqni udhëzimet në ekran për të instaluar aplikacionin ONECTA.

INFORMACION

Skanoni kodin QR për të shkarkuar dhe instaluar aplikacionin ONECTA në telefonin tuaj celular ose tablet:

6.18.3 Caktimi i lidhjes uajrles

Ka dy opsione për të lidhur përshtatësin uajrles me pajisjen tuaj inteligjente.

- Përdorni ose modalitetin e Aksesit (SSID dhe KEY) ose butonin WPS. Hapni aplikacionin ONECTA dhe ndiqni udhëzimet në ekran.

Për më shumë informacion dhe Pyetje të Shpeshta (FAQ) referojuni app.daikineurope.com.

1. Ndalni përdorimin para caktimit të lidhjes me valë.
2. Përdorni telekomandën uajrles për të zgjedhur menynë e cilësimit të LAN-it me valë.

Shënim: Gjatë caktimit, gjithmonë drejtoni telekomandën uajrles nga marrësi i sinjalit infrakuq në njësi.


Menu	Përshkrimi
1	Kontrolli i statusit të lidhjes dhe modaliteti i Pikës së Aksesit
2	Lidhja duke përdorur butonin WPS

Menu	Përshkrimi
R	Rivendos në Parazgjedhjen e caktuar nga fabrika
oFF	LAN-i me valë është OFF

Konfirmimi i statusit të lidhjes së LAN-it me valë

1 Në ekranin kryesor, shtypni [icon] për të paktën 5 sekonda ndërkohë që njësia nuk është në operim.


Rezultati: SP shfaqet në ekran. 1 vezullon.



2 Shtypni [icon] për të konfirmuar zgjedhjen.

Rezultati: 1 vezullon.

3 Kontrolloni Daikin Eye.



a Daikin eye
b Pjesërisht jeshile
c E kuqe, portokalli, blu ose e bardhë

Ngjyra e Daikin Eye ndryshon nga pjesërisht jeshile dhe…	…pastaj përshtatësi uajrles është…
i kuq	nuk është i lidhur
portokalli	po punon dhe është gati të lidhet me rrjetin e shtëpisë përmes butonit WPS në ruter.
blu	▪ lidhur me rrjetin e shtëpisë përmes modalitetit të Access Point. ose ▪ i lidhur me rrjetin e shtëpisë përmes butonit WPS në ruter.
i bardhë	fikur

4 Shtypni Cancel për të dalë nga menyja.

Rezultati: Ekrani do të kthehet te monitori kryesor.

Kthimi i cilësimit të lidhjes në parazgjedhjen e fabrikës


Rivendosni cilësimin e lidhjes në parazgjedhjen e fabrikës në rast se doni të:

- shkëputni LAN-in me valë dhe pajisjen e komunikimit (p.sh. ruter) ose pajisjen inteligjente.
- përsëritni cilësimin nëse lidhja ishte e pasuksesshme.

1 Në ekranin kryesor, shtypni [icon] për të paktën 5 sekonda ndërkohë që njësia nuk është në operim.

Rezultati: SP shfaqet në ekran. 1 vezullon.

2 Shtypni [Temp] dy herë për të ndryshuar menynë SP në A.



3 Mbajeni [icon] për të paktën 2 sekonda për të konfirmuar zgjedhjen.

Rezultati: A vezullon. Cilësimi është rivendosur në parazgjedhjen e fabrikës.

4 Shtypni [Cancel] për të dalë nga menyja.

Rezultati: Ekrani do të kthehet te monitori kryesor.


Fikja e lidhjes së LAN-it me valë

Nëse doni të fikni funksionin e lidhjes me valë:

1 Në ekranin kryesor, shtypni [icon] për të paktën 5 sekonda ndërkohë që njësia nuk është në operim.

Rezultati: SP shfaqet në ekran. 1 vezullon.

2 Shtypni [Temp] për të ndryshuar menynë SP në oFF.



3 Mbajeni [icon] për të paktën 2 sekonda për të konfirmuar zgjedhjen.


Rezultati: oFF vezullon. Komunikimi është i FIKUR.

4 Shtypni [Cancel] për të dalë nga menyja.

Rezultati: Ekrani do të kthehet te monitori kryesor.

6.19 Rreth Multi-sistemit

Në Multi-sistem, 1 njësi e jashtme është e lidhur me shumë njësi të brendshme.
Shembull:



6.19.1 Cilësimi i dhomës me përparësi

Cilësimi i dhomës me përparësi kërkon programim fillestar gjatë instalimit. Këshillohuni me shitësin e autorizuar për ndihmë.

Kur cilësimi i dhomës me përparësi është joaktiv ose jo i pranishëm

Kur punon më shumë se 1 njësi e brendshme, përparësi i jepet njësisë që është ndezur e para. Caktoni njësitë e tjera në të njëjtin modalitet operimi. Përndryshe, ato do të hyjnë në modalitetin e gatishmërisë dhe syri Daikin do të flakërojë (NUK tregon keqfunksionim).

Përjashtime: Nëse njësia e parë që është ndezur është caktuar në modalitetin **vetëm ventilator** dhe pastaj në dhomën tjetër është caktuar modaliteti **i ngrohjes**, përparësi do t'i jepet njësisë që është caktuar në modalitetin e ngrohjes. Njësia e parë do të kalojë në gatishmëri dhe syri Daikin do të flakërojë.

INFORMACION

- Modalitetet e ftohjes, tharjes dhe vetëm me ventilator mund të përdoren njëkohësisht.
- Modaliteti i operimit automatik zgjedh automatikisht ftohjen ose ngrohjen, në varësi të temperaturës së dhomës dhe cilësimit të temperaturës. Nëse zgjedhet modaliteti i operimit automatik për të gjitha njësitë, të gjitha njësitë do të operojnë në modalitetin e njësisë së parë që është ndezur.

Përparësia kur përdoret operimi në qetësi i njësisë së jashtme

Referojuni "6.14.2 Operimi në qetësi i njësisë së jashtme" [▸ 34].

1. Caktoni operimin në qetësi të njësisë së jashtme në të gjitha dhomat duke përdorur telekomandat uajrles të njësive.
2. Për të anuluar operimin në qetësi të njësisë së jashtme, mund të ndalni operimin në 1 dhomë duke përdorur telekomandën uajrles.

   Rezultati: Operimi do të ndalojë në të gjitha dhomat. do të mbetet në ekranin e telekomandave të tjera uajrles.
3. Për të hequr simbolin nga telekomandat e tjera uajrles, ndalni operimin në qetësi të njësisë së jashtme në të gjitha dhomat veçmas.

Rezultati: Simboli do të zhduket.

Kur cilësimi i dhomës me përparësi është aktiv

Mund të zgjedhësh modalitet të ndryshëm operimi për secilën dhomë.

Shembull: Dhoma A ka përparësi, sepse është zgjedhur modaliteti i operimit të ftohjes.

Modaliteti i operimit në dhomën B dhe C	Statusi i dhomës B dhe C
Ftohje, tharje ose vetëm me ventilator	Është ruajtur modaliteti aktual i operimit
Ngrohja	Modaliteti i gatishmërisë. Operimi rifillon kur dhoma A të ndalojë së operuari.
Automatik	Nëse vazhdon operimi i ftohjes. Nëse njësitë e ngrohjes hyjnë në modalitetin e gatishmërisë. Operimi rifillon kur dhoma A të ndalojë së operuari.

Përparësia kur përdoret operimi i Fuqishëm

Shembull: Dhoma A ka përparësi. Dhomat B dhe C po operojnë.

1 Caktoni operimin e Fuqishëm në dhomën A.

Rezultati: Kapaciteti në dhomën A është i rritur. Efikasiteti i ftohjes ose ngrohjes në dhomat B dhe C mund të ulet disi.

Përparësia kur përdoret operimi në qetësi i njësisë së jashtme

Shembull: Dhoma A ka përparësi.

2 Caktoni operimin në qetësi i njësisë së jashtme në një njësi.

Rezultati: Të gjitha njësitë hyjnë njëherësh në modalitetin e operimit në qetësi i njësisë së jashtme.

6.19.2 Modaliteti i heshtjes natën

Modaliteti i heshtjes natës kërkon programim fillestar gjatë instalimit. Këshillohuni me shitësin për ndihmë. Ky modalitet redukton zhurmën e operimit të njësisë së jashtme gjatë natës duke ulur efikasitetin e ftohjes.

Modaliteti i heshtjes natën është i aktivizuar automatikisht kur temperatura bie ≥5°C nën temperaturën më të lartë të regjistruar atë ditë.

6.19.3 Kyçi i modalitetit të ftohjes/ngrohjes në Multi-sistem

Kyçi i modalitetit të ftohjes/ngrohjes mund të caktohet përmes njësisë së Multi-sistemit. Këshillohuni me shitësin e autorizuar për ndihmë. Kyçi i modalitetit të ftohjes/ngrohjes e cakton njësinë të kalojë me detyrim ose në operimin e ftohjes ose ngrohjes. Aktivizoni këtë funksion nëse doni t'i caktoni të gjitha njësitë e brendshme të lidhura në një Multi-sistem në modalitetin 1 të operimit.

INFORMACION

Kyçi i modalitetit të ftohjes/ngrohjes NUK MUND të aktivizohet bashkë me cilësimin e dhomës me përparësi.

7 Kursimi i energjisë dhe operimi optimal

INFORMACION

- Edhe nëse njësia është e FIKUR, ajo konsumon elektricitet.
- Kur kthehet energjia pas një ndërprerjeje, do të rifillojë gjendja e zgjedhur më parë.

KUJDES

KURRË mos ekspozoni fëmijë të vegjël, bimë apo kafshë direkt me qarkullimin e ajrit.

NJOFTIM

MOS vini sende poshtë njësisë që NUK duhet të lagen. Kondensimi në njësi ose tubat e ftohësit ose bllokimi i drenazhit mund të shkaktojë pikim. **Pasoja e mundshme:** Sendet nën njësi mund të bëhen pis ose dëmtohen.

PARALAJMËRIM

MOS vendosni shishe me spërkatës të djegshëm afër kondicionerit dhe MOS përdorni spërkatës afër njësisë. Kjo gjë mund të shkaktojë zjarr.

KUJDES

MOS e përdorni sistemin kur përdorni një insekticid të llojit të tymosjes së dhomës. Lëndët kimike mund të mblidhen te njësia dhe të rrezikojnë shëndetin e atyre që janë hiper të ndjeshëm ndaj lëndëve kimike.

Vështroni masat paraprake për të garantuar që sistemi operon si duhet.

- Parandaloni rrezet e drejtpërdrejta të diellit që të hyjnë në dhomë gjatë operimit të ftohjes duke përdorur perde ose grila.
- Sigurohu që zona të jetë e ajruar mirë. MOS blloko vrimat e ajrimit.
- Ajrosni shpesh. Përdorimi i zgjatur kërkon vëmendje të veçantë për ajrim.
- Mbajini dyert dhe dritaret të mbyllura. Nëse dyert dhe dritaret mbeten të hapura, ajri do të dalë nga dhoma duke shkaktuar një ulje të efektit të ftohjes ose ngrohjes.
- Bëni kujdes MOS të ftohni ose ngrohni shumë. Për të kursyer energji, ruani cilësimin e temperaturës në një nivel mesatar.
- KURRË mos vendosni sende afër pjesës së hyrjes ose daljes së ajrit te njësia. Kjo mund të shkaktojë një efekt të reduktuar të ngrohjes/ftohjes ose ndaljen e operimit.
- Fikni çelësin e energjisë kryesore kur njësia NUK përdoret për periudha të gjata kohore. Nëse çelësi i energjisë kryesore është i ndezur, njësia konsumon korrent. Para rindezjes së njësisë, ndizni çelësin e energjisë kryesore 6 orë para operimit për të siguruar një funksionim të mbarë.
- Kondensimi mund të formohet nëse lagështia është mbi 80% ose nëse shkarkuesi bllokohet.
- Përshtatni temperaturën e dhomës si duhet për një mjedis të rehatshëm. Shmangni ngrohjen ose ftohjen e tepërt. Vini re që mund të duhet pak kohë që temperatura e dhomës të arrijë temperaturën e caktuar. Merrni parasysh përdorimin e opsioneve të cilësimit të kohëmatësit.
- Përshtatni drejtimin e qarkullimit të ajrit për të shmangur grumbullimin e ajrit të ftohtë në dysheme ose ajrit të ngrohtë mes murit. (Lart gjatë ftohjes ose operimit të tharjes në tavan dhe poshtë gjatë operimit të ngrohjes.)

- Shmangni qarkullimin e drejtpërdrejtë të ajrit te personat në dhomë.
- Operoni sistemin brenda gamës së rekomanduar të temperaturës (26~28°C për ftohjen dhe 20~24°C për ngrohjen) për të kursyer energjinë.

8 Mirëmbajtja dhe shërbimi

8.1 Pamje përgjithshme: Mirëmbajtja dhe shërbimi

Instaluesi duhet të kryejë një mirëmbajtje vjetore.

Rreth ftohësit

Ky produkt përmban gazra serë me fluor. MOS i lësho gazrat në atmosferë.

Lloji i ftohësit: R32

Vlera e mundshme e ngrohjes globale (GWP): 675

NJOFTIM

Legjislacioni në fuqi për **gazrat serë me fluor** kërkon që ngarkimi i ftohësit të njësisë të tregohet si në peshë ashtu edhe në ekuivalentin CO_2.

Formula për të llogaritur sasinë në tonet ekuivalente të CO_2: Vlera GWP e ftohësit × Ngarkesa totale e ftohësit [në kg] / 1000

Kontaktoni instaluesin tuaj për më shumë informacion.

NJOFTIM

Mirëmbajtja DUHET të kryhet nga një instalues i autorizuar ose agjent shërbimi.

Ne rekomandojmë kryerjen e mirëmbajtjes të paktën një herë në vit. Megjithatë, legjislacioni në fuqi mund të kërkojë intervale më të shkurtra të mirëmbajtjes.

PARALAJMËRIM

- Ftohësi brenda njësisë është pak i djegshëm, por normalisht NUK shkakton rrjedhje. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr ose formimin e një gazi të dëmshëm.
- FIKNI çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.
- MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.

PARALAJMËRIM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Për të pastruar kondicionerin ose filtrin e ajrit, sigurohuni të ndalni operacionin dhe t'i fikni të gjitha furnizimet me energji. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik. Në rast se njësia është e pajisur me sensor për rrjedhjen e ftohësit, ndizni menjëherë sërish çelësin e furnizimit me energji pas pastrimit për të ruajtur funksionalitetin e zbulimit.

KUJDES

Kur ndërroni sensorin e rrjedhjes së ftohësit R32, ndërrojeni me sensorin e specifikuar nga prodhuesi (referojuni listës së pjesëve rezervë).

PARALAJMËRIM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësinë.
- MOS e përdor njësinë me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.

KUJDES

Pas një përdorimi të gjatë, kontrollo mbështetësen e njësisë dhe montimin për dëmtime. Nëse dëmtohet, njësia mund të rrëzohet dhe çojë në dëmtim.

KUJDES

MOS i prekni krahët e shkëmbyesit të energjisë. Këto krahë janë të mprehtë dhe mund të çojnë në prerje.

Ndjekja e simboleve mund të ndodhë në njësinë e brendshme:

Simboli	Shpjegimi
	Matni voltazhin te terminalet e kondensatorëve të qarkut kryesor ose komponentëve elektrikë para shërbimit.

8.2 Pastrimi i njësisë së brendshme dhe telekomandës uajrles

PARALAJMËRIM

Detergjentët e papërshtatshëm ose procedura e pastrimit mund të shkaktojë dëmtim të përbërësve plastikë ose rrjedhje të ujit. Detergjenti i spërkatur në përbërësit elektrikë, si motorë, mund të shkaktojë avari, tym ose ndezje.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Para pastrimit, sigurohuni të ndërpritni operimin, të fikni çelësin ose të tërhiqni kordonin e korrentit. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik. Në rast se njësia është e pajisur me sensor për rrjedhjen e ftohësit, ndizni menjëherë sërish çelësin e furnizimit me energji pas pastrimit për të ruajtur funksionalitetin e zbulimit.

NJOFTIM

- MOS përdorni benzinë, benzol, hollues, pluhur për pastrim ose insekticide lëngjesh. **Pasoja e mundshme:** Çngjyrosje dhe deformim.
- MOS përdorni ujë ose ajër prej 40°C ose më lartë. **Pasoja e mundshme:** Çngjyrosje dhe deformim.
- MOS përdorni përbërje pastirmi.
- MOS përdorni furçë fërkimi. **Pasoja e mundshme:** Finishi i sipërfaqes qërohet.
- Si përdorues fundor, KURRË nuk mund t'i pastroni vetë pjesët e brendshme të njësisë; kjo punë duhet të kryhet nga një person i kualifikuar i shërbimit. Kontaktoni distributorin tuaj.

1 Pastroni me një leckë të butë. Nëse heqja e njollave është e vështirë, përdorni ujë ose një detergjent neutral.

8.3 Pastrimi i panelit të përparmë

PARALAJMËRIM

MOS e lini njësinë e brendshme të laget. **Pasoja e mundshme:** Shok elektrik ose zjarr.

NJOFTIM


- MOS përdor gazolinë, benzinë, pluhur hollues pastrimi ose insekticide të lëngshme. **Pasoja e mundshme:** Çngjyrosja dhe deformimi.
- MOS përdor ujë ose ajër 50°C ose më lart. **Pasoja e mundshme:** Çngjyrosja dhe deformimi.
- Kur lan tehun me ujë MOS e fërko fort. **Pasoja e mundshme:** Hiqet pjesa mbyllëse e sipërfaqes.

Mund ta hiqni panelin para për ta pastruar.


KUJDES

Bëni kujdes kur hapni dhe përdorni panelin para; skaji i mprehtë i panelit para mund të shkaktojë lëndim.

1 Shtyni të dy rrëshqitëset në drejtim të shigjetave derisa të dëgjohet një kërcitje.



2 Hapnin panelin para dhe zbërtheni telin.



3 Hiqni panelin e përparmë.

4 Fshijeni me një leckë të butë të lagur në ujë.

5 Lëreni të thahet në hije pas larjes.

6 Për ta vendosur sërish dhe për të mbyllur panelin para, shihni "8.10 Ri-instalimi i panelit të përparmë" [▸ 55].

8.4 Rreth filtrave të ajrit

Përdorimi i njësisë me filtra të pistë nënkupton që filtri:


- NUK MUND aromatizojë ajrin,
- NUK MUND të pastrojë ajrin,

- ngrohje/ftohje e dobët,
- shkakton aroma.

8.5 Heqja e filtrave


1 Hiqni panelin e përparmë. Referojuni "8.3 Pastrimi i panelit para" [▸ 52].

2 Hiqni me kujdes mbajtëset e filtrit të ajrit nga shulet (a) në anë. Mbani filtrin e ajrit nga doreza e filtrit (b) dhe shkëputni mbajtësen e filtrit të ajrit nga shuli (c) lart. Tërhiqni filtrin lart për të hequr mbajtëset e filtrit nga shulet në fund (d).




a Mbajtëset për shulet anash
b Doreza e filtrit
c Mbajtësja për shulin lart
d Mbajtëset për shulet në fund

3 Hiqni të dy filtrat aromatizues prej apatiti titani nga shulat (4 në secilin prej tyre).



8.6 Pastrimi i filtrit të ajrit

1 Lani filtrin e ajrit me ujë ose pastroni me fshesë korrenti.



INFORMACION


- Nëse pluhuri NUK hiqet lehtësisht, lani me një detergjent neutral në ujë të vakët. Thani filtrat e ajrit në hije.
- Rekomandohet pastrimi i filtrave të ajrit çdo 2 javë.

8.7 Pastrimi i filtrit aromatizues prej apatiti titani


INFORMACION

Pastroni filtrin me ujë çdo 6 muaj.

1 Hiqni pluhurin nga filtri me një fshesë korrenti.



2 Futeni filtrin në ujë të ngrohtë për rreth 10 - 15 minuta. MOS e hiqni filtrin nga skeleti.




3 Pas larjes, hiqni ujin e mbetur duke e shkundur atë dhe thani filtrin në hije. MOS e shtrydhni filtrin kur hiqni ujin.

8.8 Ndërrimi i filtrit aromatizues prej apatiti titani

INFORMACION

Ndërroni filtrin çdo 3 vjet.

1 Hiqni filtrin nga lidhësja e kornizës së filtrit dhe ndërroni filtrin me një të ri.




INFORMACION


- MOS e hidhni skeletin e filtrit dhe përdorini sërish ato.
- Hidheni filtrin e vjetër si mbeturina jo të djegshme.

8.9 Rivendosja e filtrave

1 Fiksoni të dy filtrat aromatizues prej apatiti titani në shula (4 në secilin prej tyre).




2 Vendosni mbrojtëset e filtrit në shulin në fund (d). Mbani filtrin e ajrit nga doreza e filtrit (b) dhe vendosni mbajtësen e filtrit të ajrit në shulin (c) lart. Vendosni mbajtëset e filtrit të ajrit në shulat (a) në anë. Sigurohuni që filtri i ajrit është i fiksuar në mënyrë të sigurt në të gjitha pozicionet.




a Mbajtëset për shulet anash
b Doreza e filtrit
c Mbajtësja për shulin lart
d Mbajtëset për shulet në fund

8.10 Ri-instalimi i panelit të përparmë


1 Vendosni panelin para në ullukët e njësisë (3 vende) dhe ngjitni telin.



2 Mbyllni panelin para dhe shtyni të dy rrëshqitëset derisa të dëgjohet një kërcitje.



3 Shtyni anash panelit para për t'u siguruar që paneli para është i fiksuar në mënyrë të sigurt.



8.11 Marrja parasysh e pikave të mëposhtme para një periudhe të gjatë

1 Pas ndërprerjes së operimit, FIKUR çelësin.

2 Pastroni filtrat e ajrit dhe zëvendësojini në pozicionin e tyre fillestar.

3 Hiqni bateritë nga telekomanda uajrles.

INFORMACION

Rekomandohet mirëmbajtja periodike që kryhet nga një specialist. Për mirëmbajtje specialiste, kontaktoni distributorin tuaj. Kostot e mirëmbajtjes do të mbulohen nga klienti.

Në kushte të caktuara operimi pjesa e brendshme e njësisë mund të bëhet pis pas disa sezoneve përdorim. Kjo mund të çojë në një performancë të dobët.

9 Zgjidhja

Nëse ndodh njëra nga këto keqfunksionime, merrni masat e treguara poshtë dhe kontaktoni distributorin tuaj.

PARALAJMËRIM

Ndalo operimin dhe fik energjinë, nëse ndodh diçka e pazakontë (erë djegieje, etj.).

Lënia e njësisë në punë në këto rrethana mund të shkaktojë prishje, tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.

PARALAJMËRIM

Në rast se njësia është e pajisur me sensor për rrjedhjen e ftohësit, fikni njësinë duke përdorur butonin ON/OFF për fikje/ndezje vetëm te ndërfaqja e përdoruesit.

Sistemi DUHET të riparohet nga një person i kualifikuar për shërbim.

Keqfunksionimi	Matja
Nëse një pajisje sigurie si siguresa, çelësi ose një çelës për rrjedhje tokëzimi vihet vazhdimisht në lëvizje ose çelësi i NDEZJES/FIKJES NUK punon si duhet.	FIKNI çelësin e energjisë kryesore.
Nëse rrjedh ujë nga njësia.	Ndalo operimin.
Çelësi i operimit NUK punon si duhet.	FIKNI energjinë.
Daikin Eye ndriçon dhe me anën e telekomandës uajrles mund të kontrolloni kodin e gabimit. Për të shfaqur kodin e gabimit, shikoni "9.3 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit" [▸ 63].	Njoftoni instaluesin tuaj dhe raportoni kodin e gabimit.

Nëse sistemi NUK operon siç duhet përveç rasteve të lartpërmendura dhe asnjëra nga keqfunksionimet e përmendura nuk është e dukshme, hetoni sistemin në përputhje me procedurat vijuese.

Keqfunksionimi	Matja
Nëse sistemi NUK operon fare.	▪ Kontrolloni nëse ka avari të energjisë. Prisni derisa të rikthehet energjia. Nëse gjatë përdorimit ndodh një avari e energjisë, sistemi rifillon automatikisht menjëherë pas rikthimit të energjisë. ▪ Kontrolloni nëse është djegur siguresa ose është aktivizuar çelësi. Ndërroni siguresën ose rivendosni çelësin nëse është e nevojshme. ▪ Kontrolloni baterinë e telekomandës uajrles.
Papritur sistemi ndalon së operuari.	▪ Kontrolloni nëse pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit të njësisë së jashtme ose të brendshme NOT është e bllokuar nga pengesa. Hiqni çdo pengesë dhe sigurohuni që ajri të mund të qarkullojë lirisht. ▪ Kondicioneri mund të ndalojë operimin pas luhatjeve të papritura të mëdha të voltazhit për të mbrojtur sistemin. Rivendos automatikisht operimin pas 3 minutave.

Keqfunksionimi	Matja
Sistemi operon, por ftohja ose ngrohja nuk mjafton.	▪ Kontrolloni cilësimin e shkallës së qarkullimit të ajrit. Referojuni "6.4 Shkalla e qarkullimit të ajrit" [▸ 23]. ▪ Kontrolloni cilësimin e temperaturës. Referojuni "6.3.1 Fillimi/ndalja e modalitetit të operimit dhe caktimi i temperaturës" [▸ 22]. ▪ Kontrolloni nëse cilësimi i drejtimit të qarkullimit të ajrit është i duhuri. Referojuni "6.5 Drejtimi i qarkullimit të ajrit" [▸ 23]. ▪ Kontrolloni nëse pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit të njësisë së jashtme ose të brendshme NOT është e bllokuar nga pengesa. Hiqni çdo pengesë dhe sigurohuni që ajri të mund të qarkullojë lirisht.
Sistemi operon, por ftohja ose ngrohja nuk mjafton (NUK lëshohet ajri nga njësia).	▪ Kondicioneri mund të ngrohet për operimin të ngrohtë. Prisni nga 1 në 4 minuta. ▪ Njësia mund të jetë në operimin e shkrirjes së akullit.
Sistemi operon, por ftohja ose ngrohja nuk mjafton (ajri lëshohet nga njësia).	▪ Kontrolloni nëse filtrat e ajrit janë të bllokuara. Pastroni filtrat e ajrit. Shikoni "8 Mirëmbajtja dhe shërbimi" [▸ 50]. ▪ Kontrolloni nëse ka dyer ose dritare të hapura. Mbyllni dyert dhe dritaret për të penguar hyrjen e erës. ▪ Kontrolloni nëse njësia operon në operimin Econo. Referojuni "6.14.1 Operimi ekono" [▸ 34]. ▪ Kontrolloni nëse ka mobilie direkt ngjitur me njësinë e brendshme. Lëvizni mobiliet.
Gjatë operimit ndodh një funksion anormal.	Kondicioneri mund të mos punojë mirë për shkak të ndriçimit ose valëve të radios. Kthejeni ndërprerësin në OFF dhe sërish në ON.
Njësia NUK merr sinjale nga telekomanda uajrles.	▪ Kontrolloni baterinë e telekomandës uajrles. ▪ Kontrolloni nëse transmetuesi NUK ekspozohet në rrezet e drejtpërdrejta të diellit. ▪ Kontrolloni nëse ka llamba fluoreshente të llojit startues elektronik në dhomë. Kontaktoni distributorin tuaj.
Ekrani i telekomandës uajrles është bosh ose shfaq .	Ndërroni baterinë e telekomandës uajrles.
Mund të kontrolloni kodin e gabimit me anën e ndërfaqes së përdoruesit (telekomanda uajrles).	Këshillohuni me shitësin lokal. Referojuni "9.3 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit" [▸ 63] për mënyrën si të kontrolloni kodet e gabimit dhe për një listë të detajuar të kodeve të gabimit.
Aparaturat e tjera elektrike fillojnë të operojnë.	Nëse sinjalet e telekomandës uajrles operojnë aparaturat e tjera elektrike, largoni aparaturat e tjera dhe kontaktoni me shitësin tuaj.

E zbatueshme vetëm për njësitë me sensor të rrjedhjes së ftohësit:

Keqfunksionimi	Matja
Ventilatori rrotullohet, edhe kur njësia është e fikur. (Llamba e operimit vezullon)	**Sensori i rrjedhjes së ftohësit nisi punën:** ▪ Nëse kodi i gabimit "A0" shfaqet në monitorin e ndërfaqes së përdoruesit (telekomanda uajrles), mund të ketë rrjedhje të ftohësit. Ajrosni dhomën dhe kontaktoni shitësin tuaj. ▪ Nëse kodi i gabimit "A0" NUK shfaqet në monitorin e ndërfaqes së përdoruesit (telekomanda uajrles), nuk ka rrjedhje të ftohësit ose zbulimi është akoma i aktivizuar. Nëse nuk zbulohet rrjedhje, ventilatori do të fiket automatikisht pas disa minutave.
Njësia nuk ngroh ose ftoh dhe cilësimi i ajrimit ka kaluar në "Rrjedhje e fortë e ajrit". (Llamba e operimit vezullon)	
Ventilatori i njësisë së brendshme ose të jashtme rrotullohet edhe kur njësia është e fikur.	
Kodi i gabimit "A0" shfaqet në ekranin e ndërfaqes së përdoruesit (telekomanda uajrles).	
Dëgjohet vazhdimisht një bip dhe kodi i gabimit të ndërfaqes së përdoruesit (telekomanda uajrles) A0	**Sensori i rrjedhjes së ftohësit nisi punën:** ▪ Konfirmohet rrjedhja e ftohësit. Ajrosni dhomën dhe kontaktoni shitësin tuaj.
Kodi i gabimit "CH" shfaqet në ekranin e ndërfaqes së përdoruesit.	▪ Keqfunksionim i sensorit të rrjedhjes së ftohësit. ▪ Kablloja e sensorit të rrjedhjes së ftohësit është e prishur. ▪ Kablloja e lidhjes së sensorit të rrjedhjes së ftohësit nuk është e plotë. ▪ Keqfunksionim i qarkut kryesor të shtypur. Kontaktoni distributorin tuaj.
Vetëm për kombinim të shumëfishtë: Njësia NUK operon (pulson llamba e operimit), shfaqet kodi i gabimit "UH"	▪ Mund të ketë rrjedhje të ftohësit që diktohet në njësinë tjetër të lidhur me sensor kundër rrjedhjes së ftohësit. Kontrolloni të gjitha njësitë e lidhura CVXM dhe FVXM për gabim A0 ose CH.

Kodet e gabimit për sensorin kundër rrjedhjes së ftohësit

Indikacioni i kodit ndryshon siç tregohet më poshtë.

Kodi kryesor	Përmbajtja
A0	Zbulimi i rrjedhjes së ftohësit.
CH	Anomali e sensorit të rrjedhjes së ftohësit.

INFORMACION

Për të ndaluar sinjalizimin audio (bipi i vazhdueshëm) në rast të zbulimit të rrjedhjes së ftohësit, shtypni Cancel për 5 sekonda.

Pas kontrollimit të të gjithë artikujve më lart, nëse është e pamundur ta rregulloni vetë problemin, kontaktoni instaluesin dhe tregoni simptomat, emrin e plotë të

modelit të njësisë (me numrin e prodhimit nëse është e mundur) dhe datën e instalimit.

9.1 Zgjidhja e problemeve për lidhjen e LAN-it me valë

Tabela e mëposhtme jep një përshkrim të shkurtër për mënyrën e trajtimit të disa problemeve. Nëse asnjëra nga zgjidhjet nuk ju ndihmon, atëherë shkoni te app.daikineurope.com për më shumë informacion dhe pyetje të shpeshta FAQ.

Problemi	Masë
Lidhja me LAN-in me valë nuk është e mundur (syri Daikin NUK po vezullon gjatë caktimit të lidhjes LAN me valë).	▪ Provoni ta përdorni njësinë me telekomandën uajrles. ▪ Kontrolloni nëse është lidhur me korrentin. ▪ Fikni dhe ndizni sërish njësinë.
LAN-i me valë NUK është i dukshëm tek ekrani i pasqyrimit të njësisë (ekrani kryesor) pasi të jetë konfiguruar përshtatësi WLAN (opsioni WPS).	▪ Sigurohuni që LAN-i me valë të jetë mjaftueshëm afër me pajisjen e komunikimit. ▪ Kontrolloni nëse komunikimi është OK. ▪ Sigurohuni që pajisja inteligjente është e lidhur me të njëjtin rrjet me valë si LAN-i uajrles. ▪ Provoni ta ktheni cilësimin te parazgjedhja e fabrikës dhe përsëritni cilësimin. Shikoni "Kthimi i cilësimit të lidhjes në parazgjedhjen e fabrikës" [▸ 44].
LAN-i me valë NUK është i dukshëm te lista e rrjeteve të disponueshme Wi-Fi te pajisja inteligjente (opsioni i pikës së aksesit).	▪ Provoni të kaloni nga pika e aksesit dhe cilësimi WPS për të ndryshuar kanalin uajrles. Kanali uajrles DUHET të jetë mes 1~13. ▪ Kontrolloni nëse komunikimi është OK. ▪ Provoni ta ktheni cilësimin te parazgjedhja e fabrikës dhe përsëritni cilësimin. Shikoni "Kthimi i cilësimit të lidhjes në parazgjedhjen e fabrikës" [▸ 44].
Vlera e temperaturës së brenda/jashtë shfaqur në aplikacionin ONECTA ndryshon nga vlera e matur nga pajisje të tjera.	▪ Aplikacioni ONECTA shfaq temperaturën brenda/jashtë për zonën që rrethon vetëm njësinë e brendshme/jashtme. ▪ Temperatura e matur për pajisjet e tjera mund të ndryshojë për shkak të gjendjes së ndryshme përreth njësisë (p.sh. rrezet e drejtpërdrejta të diellit, grumbullimi i ngricës…) ▪ Temperatura e shfaqur në aplikacionin ONECTA është vetëm për informacion.

9.2 Simptomat që NUK janë keqfunksionime të sistemit

Simptomat vijuese NUK janë keqfunksionime të sistemit:

9.2.1 Shenja: Temperatura e qarkullimit të ajrit NUK është aq e lartë gjatë operimit të Nxehjes Plus

- Kur temperatura jashtë është e ulët dhe bie nën pikën e ngrirjes, temperatura e qarkullimit të ajrit mund të jetë e pamjaftueshme.
- Gjatë operimit në shumë dhoma me lidhje të shumta të njësive të jashtme, temperatura e ajrit të shkarkimit mund të mund të mos arrijë një vlerë të mjaftueshme.

9.2.2 Simptoma: Dëgjohet një zë sikur rrjedh ujë

- Ky zë shkaktohet nga rrjedhja e ftohësit në njësi.
- Ky zë mund të krijohet kur uji del nga njësia gjatë operimit të ftohjes ose tharjes.

9.2.3 Simptoma: Dëgjohet një zë fryrës

Ky zë krijohet kur ndryshon drejtimi i qarkullimit të ftohësit (p.sh. kur kalon nga ftohja në ngrohje).

9.2.4 Simptoma: Dëgjohet një zë tik-tak

Ky zë krijohet kur njësia zgjerohet paksa ose tkurret pas ndryshimeve në temperaturë.

9.2.5 Simptoma: Dëgjohet një zë fishkëllues

Ky zë shkaktohet nga rrjedhja e ftohësit gjatë operimit të heqjes së ngricës.

9.2.6 Simptoma: Dëgjohet një zë gjatë operimit ose kohës jo produktive

Ky zë shkaktohet kur operojnë valvulet e kontrollit të ftohësit ose pjesët elektrike.

9.2.7 Simptoma: Dëgjohet një zë gjëmues

Ky zë krijohet kur një pajisje e jashtme thith ajrin e dhomës (p.sh. ventilatori i shkarkimit, kapaku i ekstraktorit) kur dyert dhe dritaret në dhomë janë të mbyllura. Hapni dyert ose dritaret ose fikni pajisjen.

9.2.8 Shenja: Nga njësia (njësia e brendshme) dalin pikla të bardha

- Kur lagështia është e lartë gjatë operimit të ftohjes (në vende me vaj dhe pluhur). Nëse pjesa e brendshme e një njësie të brendshme është ndotur keq, shpërndarja e temperaturës brenda dhomës bëhet jo e rregullt. Është e nevojshme pastrimi i pjesës së brendshme të njësisë së brendshme. Pyesni distributorin tuaj për detaje mbi pastrimin e njësisë. Ky operim kërkon një person të kualifikuar shërbimi.
- Kur kondicioneri kalon në operimin me ngrohje pas heqjes së ngricës. Lagështia e krijuar nga heqja e ngricës bëhet avull dhe del.

9.2.9 Shenja: Njësitë mund të lëshojnë aroma

Njësia mund të thithë erën e dhomave, mobilieve, cigareve, etj., dhe pastaj i lëshon sërish.

9.2.10 Simptoma: Ventilatori i jashtëm rrotullohet kur kondicioneri nuk është në përdorim

- **Pasi ka ndaluar operimi.** Ventilatori i jashtëm vazhdon të rrotullohet për 30 sekonda të tjera për mbrojtjen e sistemit.
- **Kur kondicioneri nuk është në përdorim.** Kur temperatura e jashtme është shumë e lartë, ventilatori i jashtëm fillon të rrotullohet për mbrojtjen e sistemit.

9.2.11 Shenja: Shpejtësia ventilatorit NUK përkon me vlerën e dëshiruar

- Gjatë operimit të ftohjes në sistemin me shumë njësi, njësia e brendshme mund të ndryshojë shpejtësinë e ventilatorit në të lartë, pavarësisht cilësimit të përdoruesit për të hequr brymën nga shkëmbyesi i nxehtësisë së njësisë së brendshme.
- Gjatë operimit në heshtje të njësisë së brendshme, kur si temperatura e ambientit jashtë dhe brenda është tepër e lartë, njësia e brendshme e rrit shpejtësinë e ventilatorit për të mbrojtur sistemin.

9.2.12 Shenja: Disa ikona operimi nuk janë të dukshme në telekomandën uajrles ose disa funksione nuk mund të aktivizohen në aplikacionin ONECTA

Disa kombinime të veçorive nuk lejohen (shembull: modaliteti "Vetëm me ventilator" dhe operimi i qetë i njësisë së jashtme). Kjo veçori mund të shfaqet në aplikacionin ONECTA, por funksioni NUK MUND të aktivizohet.

9.2.13 Shenja: Në aplikacionin ONECTA, operimi i fuqishëm NUK tregohet si aktiv

Kur aktivizohet operimi i fuqishëm ndërkohë që njësia e brendshme është FIKUR, operimi i fuqishëm nuk mund të shfaqet si aktiv për 2 minuta derisa të përditësohen të dhënat e platformës re.

9.2.14 Shenja: Modaliteti automatik NUK është i çaktivizuar në aplikacionin ONECTA me cilësimin e kufirit të Temperaturës

Nëse kufiri i sipërm i ngrohjes është i caktuar më poshtë se kufiri i poshtëm i ftohjes në aplikacionin ONECTA, atëherë modaliteti automatik mbështetet në aplikacionin ONECTA. Njësia mund të operojë në ngrohje mes vlerës minimale të vlerës së dëshiruar dhe kufirit të sipërm të ngrohjes dhe në ftohje mes kufirit të poshtëm të ftohjes dhe vlerës maksimale të dëshiruar.

9.2.15 Shenja: Kohëmatësi javor NUK çaktivizohet kur kufiri i temperaturës ndryshon në aplikacionin ONECTA

Nëse kufiri i temperaturës ndryshon në aplikacionin ONECTA, kohëmatësi javor mbetet aktiv. Cilësimet e kohëmatësit javor mbeten të pandryshuara në aplikacionin ONECTA. Cilësimet e vlerës së dëshiruar në kohëmatësin javor NUK kufizohen, edhe nëse kufijtë e temperaturës janë të vendosur në aplikacionin ONECTA.

Megjithatë, njësia mund të kufizojë vlerën e dëshiruar gjatë operimit nëse është jashtë gamës së lejuar. Vlera aktuale e dëshiruar shfaqet në ekranin kryesor të njësisë në aplikacionin ONECTA.

9.2.16 Shenja: Aplikacioni ONECTA reagon me vonesë

Mund të ketë një vonesë në shfaqjen e aplikacionit për shkak të përditësimeve të të dhënave.

9.3 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit

Diagnoza e defekteve me telekomandën uajrles

Nëse njësia has në një problem, mund të identifikoni defektin duke kontrolluar kodin e gabimit nga telekomanda uajrles. Është e rëndësishme të kuptohet problemi dhe marrja e masave para rivendosjes së kodit të gabimit. Kjo duhet të bëhet nga një instalues i licencuar ose distributori juaj lokal.

INFORMACION

Shikoni manualin e shërbimit për:

- Listën e plotë të kodeve të gabimit
- Një udhëzim më të detajuar për zgjidhjen e problemeve për secilin gabim

Për të kontrolluar kodin e gabimit nga telekomanda uajrles

1 Synoni telekomandën uajrles nga njësia dhe shtypni Cancel për rreth 5 sekonda.

Rezultati: 00 pulson te pjesa e ekranit të cilësimit të temperaturës.

2 Synoni telekomandën uajrles nga njësia dhe shtypni Cancel në mënyrë të përsëritur derisa të dëgjohet një bip i vazhdueshëm.

Rezultati: Tani kodi shfaqet në monitor.

INFORMACION

- Një bip i shkurtër dhe 2 bipa të njëpasnjëshëm tregojnë kode jo korrespondues.
- Për të anuluar ekranin e kodit, mbani shtypur Cancel për 5 sekonda. Edhe kodi do të zhduket nga monitori nëse butoni NUK shtypet brenda 1 minute.

Sistemi

Kodi i gabimit	Përshkrimi
00	Normale
U0	Sasia e paktë e ftohësit
U2	Zbulimi i mbivoltazhit
U3	Keqfunksionim i transmetimit
U4	Gabim në transmetimin e sinjalit (mes njësisë së brendshme dhe të jashtme)
U8	Defekti i kombinimit të njësisë së brendshme/jashtme
UH	Keqfunksionim i sistemit

Njësia e brendshme

Kodi i gabimit	Përshkrimi
A0	Zbulimi i rrjedhjes së ftohësit[a]
A1	Anormaliteti PCB i njësisë së brendshme
A5	Mbrojtja kundër ngrirjes ose kontrolli i presionit të lartë

Kodi i gabimit	Përshkrimi
A6	Anormaliteti i motorit të ventilatorit (motori DC)
AH	Gabim në njësinë e Streamer
CH	Anomali e sensorit të rrjedhjes së ftohësit[a]
C4	Anormaliteti i termistorit të shkëmbyesit të brendshëm të ngrohjes
C9	Anormaliteti i termistorit të temperaturës së dhomës
CC	Gabimi i sensorit të lagështisë

[a] E zbatueshme vetëm për njësitë me sensor të rrjedhjes së ftohësit.

Njësia e jashtme

Kodi i gabimit	Përshkrimi
EA	Anormaliteti i valvulit me 4 drejtime
E1	Anormaliteti PCB i njësisë së jashtme
E3	Aktivizimi i çelësit të presionit të lartë (HPS)
E5	Aktivizimi i mbingarkesës (mbingarkesa e kompresorit)
E6	Kyçja e kompresorit
E7	Kyçja e ventilatorit DC
F3	Kontrolli i temperaturës së tubit të shkarkimit
F6	Kontrolli i presionit të lartë (në gjendje ftohje)
H0	Anormaliteti i sensorit të sistemit të kompresorit
H3	Keqfunksionimi i çelësit të presionit të lartë (HPS)
H6	Anormaliteti i sensorit të pozicionit
H8	Anormaliteti i sensorit të voltazhit DC / rrymës
H9	Anormaliteti i termistorit të temperaturës së jashtme
J3	Anormaliteti i termistorit të tubit të shkarkimit
J6	Anormaliteti i termistorit të shkëmbyesit të jashtëm të ngrohjes
J8	Keqfunksionimi i termistorit të tubit të lëngjeve (qarku i ftohësit dhe të tjerë)
L3	Gabimi i ngrohjes së pjesëve elektrike
L4	Rritja e temperaturës së krahut të rrezatimit
L5	Mbirryma e menjëhershme e inverterit (DC)
P4	Anormaliteti i termistorit të të krahut të rrezatimit
F8	Gabimi i temperaturës së brendshme të kompresorit

10 Hedhja

NJOFTIM

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

11 Fjalor

DHW = Ujë i nxehtë shtëpiak
Ujë i nxehtë i përdorur në çdo lloj ndërtese, për qëllime shtëpiake.

Shitësi
Shpërndarësi i shitjeve për produktin.

Instaluesi i autorizuar
Personi me aftësi teknike, i cili është i kualifikuar për të instaluar produktin.

Përdoruesi
Personi që është zotëruesi i produktit dhe/ose operon produktin.

Legjislacioni në fuqi
Të gjitha direktivat, ligjet, rregullat dhe/ose kodet ndërkombëtare, evropiane, kombëtare dhe vendore, që lidhen dhe përdoren për një produkt ose domen të caktuar.

Kompania e shërbimit
Kompania e kualifikuar që mund të kryejë ose bashkërendojë shërbimin e kërkuar të produktit.


Manuali i instalimit
Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

Manuali i përdorimit
Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar përdorimin e tij.

Aksesorë
Etiketa, manuale, fletëudhëzues dhe pajisje, që dorëzohen me produktin dhe që kanë nevojë të instalohen në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Pajisjet opsionale
Pajisje prodhuar ose miratuar nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Furnizuar nga instaluesi
Pajisje të prodhuara JO nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet te dokumentacioni shoqërues.



EAC

Copyright 2026 Daikin

DAIKIN INDUSTRIES CZECH REPUBLIC s.r.o.
U Nové Hospody 1155/1, 301 00 Plzeň Skvrňany, Czech Republic

DAIKIN EUROPE N.V.
Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

4P847294-10 2026.06